

Udhëzues për



Start



UP

-et

osce

Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
Prezenca në Shqipëri

Deloitte.  
Legal

## Përmbajtja

Parathënie	5
Përkuftizime	6
Akronime	8
Hyrje	9
Udhëzuesi	11

### I. Kreu I: Krijimi i një startup-i 12

1. Startup-et në Shqipëri	12
1.1. Çfarë do të konsiderohet "startup" bazuar në Ligjin për Startup-et?	12
1.2. Si merret statusi "startup" sipas Ligjit për Startup-et?	12
1.3. Si mund të aksesohet regjistri elektronik i startup-eve	12
1.4. Çfarë përfitimesh rrjedhin nga regjistrimi si startup?	12
1.5. A e dini se ka disa mënyra të mbështetjes së startup-eve?	13
2. Format e organizimit ligjor të një startup-i	13
2.1. Çfarë është personi fizik tregtar?	14
2.2. Cilat janë detyrimet kryesore të një personi fizik tregtar?	14
3. Shoqëritë tregtare	14
3.1. Cila është forma më e rekomanduar e organizimit për një startup?	14
4. Themelimi dhe regjistrimi i biznesit	15
4.1. Cilat janë hapat e themelimit dhe regjistrimit të një startup-i?	14
4.2. Detyrimi për Identifikimin e Pronarit Përfitues (UBO)	15
4.3. Cilat janë regjistrimet e nevojshme pranë organeve tatimore	15

### II. Kreu II: Përmbushja e detyrimeve ligjore në vijmësi (compliance) 17

1. Si mund të garantohet përputhshmëria me kuadrin ligjor të zbatueshëm (compliance)?	17
2. Çështje të punësimit	17
2.1. Përse është e rëndësishme njohja e legjislacionit të punës?	17
2.2. Çfarë duhet të kenë parasysh startup-et lidhur me procedurat e rekrutimit?	17
2.3. Si fillon marrëdhënia e punës?	18
2.4. A e dini se ka disa lloje të kontratave të punës që mund të nënshkruhen me punëmarrësin?	18
2.5. Çfarë elementesh kryesore duhet të përmbajë kontrata e punës në mënyrë që të shmangen sanksionet e mundshme nga Inspektorati i Punës?	19
2.6. Trajtimi i punëmarrësit me integritet	19
2.7. A e dini se çfarë do të konsiderohen si orë pune shtesë?	20
2.8. Leja e lindjes dhe përfitimet	21
2.9. Kompensimi i orëve të punës shtesë	21
2.10. Kur dhe si mund të zgjidhet kontrata e punës?	22

## Udhëzues për Startup-et

Themelimi, regjistrimi, dhe mbarëvajtja e aktivitetit ekonomik në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si dhe parimet kryesore të ushtrimit të aktivitetit tregtar me integritet

### DEKLARATË PËRGJEGJËSIE:

Ky botim është mbështetur nga projekti i OSBE "Zhvilluesit dhe Sipërmarrësit e Rinj që Nxisin Startup-et" (YDEAS II). Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë detyrimisht ato të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), qeverisë italiane, qeverisë gjermane, qeverisë polake, apo të Deloitte Legal Sh.p.k.

E drejta e autorit © Prezenca e OSBE-së në Shqipëri 2023  
Autorët: Deloitte Legal Sh.p.k.



Ministry of Foreign Affairs  
and International Cooperation



Federal Foreign Office



Permanent Mission  
of the Republic of Poland  
to the Organization for Security  
and Co-operation in Europe

2.11. Cilat janë hapat që duhet të ndjek si punëdhënës nëse kam vendosur të zgjidh kontratën e punës me një punëmarrës?	22
2.12. A e dini se disa detyrime duhet të zbatohen edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës?	23
2.13. A e dini se ju si punëdhënës keni disa detyrime në kuadër të garantimit të sigurisë dhe shëndetit në punë?	23
3. Përbushja e detyrimeve të legjisllacionit tatimor	24
3.1. Kur dhe si duhet t'i deklaroj punëmarrësit pranë organeve tatimore?	25
3.2. Si bëhet përlogaritja dhe deklarimi i kontributeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore?	25
3.3. Si taten të ardhurat personale nga punësimi?	26
3.4. Cilat janë detyrimet e një startup-i lidhur me hartimin dhe deklarimin e pasqyrave?	27
4. Mbrojtja e të dhënave personale	27
4.1. Si rregullohet mbrojtja e të dhënave personale?	27
4.2. Çfarë është një e dhënë personale?	28
4.3. Cilat aktivitete do të konsiderohen si përpunim i të dhënave personale?	28
4.4. Përse është e rëndësishme njohja e legjisllacionit për mbrojtjen e të dhënave personale?	28
4.5. A i njihni detyrimet tuaja kryesore si kontrollues të dhënash?	29
4.6. Çfarë masash teknike dhe organizative mund të marr si startup me qëllim ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale që përpunoj?	29

### III. Kreu III: Si të mbron logon tuaj? 29

1. Pronësia Intelektuale	29
2. Marka tregtare	30
2.1. Përse është i rëndësishëm regjistrimi i markës?	30
2.2. Si mund ta regjistroj markën tregtare?	30

### IV. Kreu IV: Integriteti dhe etika gjatë ushtrimit të aktivitetit tregtar 31

1. Integriteti dhe etika në biznes	31
1.1. Si të veprojmë që të sigurohem se startup-i po operon me integritet?	32
1.2. Më shumë informacion rreth etikës dhe integritetit në biznes	32
1.3. Çfarë është konflikti i interesit?	33
1.4. Çfarë ndalimesh ka për lidhjen e kontratave me shoqërinë?	33
1.5. A i zbatohen një startup-i dispozitat e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit?	34
1.6. Çfarë detyrimesh ka një startup në kuadër të legjisllacionit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve?	35

### V. Kreu V: Pyetjet më të shpeshta nga bizneset (FAQs) 36

## Parathënie

Të nderuar sipërmarrës (të ardhshëm),

Keni marrë vendimin – ose të paktën po mendoni – të shfrytëzoni morinë e mundësive që ofron Shqipëria për ata që duan të krijojnë dhe rrisin bizneset e tyre. Urime!

Lundrimi në detin e kërkesave ligjore dhe rregullatore mund të duket si një sfidë e madhe në fillim. Mos hezitoni – do të gjeni burime të shumta që do t'ju ndihmojnë të orientoheni në këtë proces të domosdoshëm – përfshirë edhe këtë Udhëzues. Është me rëndësi parësore që sipërmarrësit e rinj të kenë informacione të besueshme dhe të përditësuara për kuadrin ligjor në fushën e ekonomisë, prandaj ne menduam t'ju siguronim një mundësi të tillë!

Parimet themelore të biznesit janë integriteti, transparenca dhe konkurrenca e lirë dhe e ndershme. Kemi kënaqësinë t'ju paraqesim Udhëzuesin për StartUp-et, një udhërrëfyes i plotë për ju, hartuar me kujdes nga një grup ekspertësh për pajtueshmërinë e bizneseve me ligjet dhe rregullat. Me këtë Udhëzues, mund të orientoheni në çështjet e ndërlikuara ligjore, në respekt të standardeve më të larta të integritetit dhe etikës në marrjen e vendimeve të informuara.

Edhe pse rrugëtimi i startup-eve është i mbushur me sfida dhe pasiguri, përfitimet mund të kenë përmasa transformuese, me potencialin për të revolucionarizuar sektorët e industrive, për të përshpejtuar rritjen ekonomike dhe formësuar të ardhmen e biznesit. Ndërsa filloni rrugëtimin e biznesit personal në mjedisin dinamik të biznesit në Shqipëri, shpresoj që ky Udhëzues t'ju frymëzojë dhe t'ju fuqizojë për të ngritur biznese që jo vetëm janë të suksesshme, por edhe që ndikojnë pozitivisht në forcimin e kohezionit të pandarë ekonomik dhe social në vend.

Sa më shumë suksese në përpjekjet tuaja,

**Clarisse Pasztor**

Kryetarja në Detyrë, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

*Ky udhëzues u hartua në kuadër të projektit ekstra buxhetor "Zhvilluesit dhe Sipërmarrësit e Rinj që Nxisin StartUp-et" (YDEAS II), zbatuar nga Zyra e Koordinatorit të Aktiviteteve Ekonomike dhe Mjedisore të OSBE-së dhe mbështetur nga qeveritë e Italisë, Gjermanisë dhe Polonisë. Në mbështetje të përpjekjeve të vazhdueshme për arsim dhe përfshirje, projekti synon të rrisë mundësitë për zhvillimin e aftësive dhe krijimin e vendeve të punës, përmirësimin e kushteve të punësimit për të rinjtë dhe gratë, ndërsa nxit një mjedis të favorshëm për sipërmarrësit e rinj, risinë, ndikimin social dhe startup-et në ekonominë e gjelbër.*

## Përkufizime

<b>Akt Themelimi</b>	Akt Themelimi është marrëveshja e arritur midis themeluesve për krijimin e një shoqërie.
<b>Statut</b>	Akti nëpërmjet të cilit ortakët/aksionarët e një shoqërie tregtare parashikojnë të gjitha rregullimet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre, strukturës së drejtimit dhe mënyrave të vendimmarrjes dhe përgjegjësisë në bazë të ligjit..
<b>Regjistri Tregtar</b>	Në kuptim të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit", të ndryshuar, regjistri është një bazë të dhënash unike, e ndarë në dosje të veçanta elektronike për secilin subjekt që ka detyrimin e regjistrimit sipas ligjit të zbatueshëm. Regjistri Tregtar është publik dhe mund të qaset nga të gjithë të interesuarit.  Në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit", të ndryshuar, çdo e dhënë, e regjistruar dhe e publikuar në regjistrin tregtar, vlerësohet e njohur dhe mund t'u kundrejtohet të tretëve nga dita e publikimit të tyre.
<b>Asambleja e Përgjithshme</b>	Organi ku mbledhen dhe marrin vendime zotëruesit e kuotave/aksioneve të shoqërisë tregtare.
<b>Administratori</b>	Personi, që ushtron drejtimin, menaxhimin dhe administrimin e shoqërisë tregtare.
<b>E-albania</b>	E-Albania është portali qeveritar ku shërbimet publike që gjenden në zyrat dhe sportelet fizike të institucioneve ofrohen në mënyrë elektronike falë Platformës Qeveritare të Ndërveprimit që ndërlihdh sistemet e institucioneve me njeri-tjetrin.
<b>Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare</b>	Nënkupton ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.
<b>Ligji për QKB</b>	Nënkupton ligjin nr. 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".
<b>Ligji për Regjistrimin e Biznesit</b>	Nënkupton ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e Biznesit", të ndryshuar.
<b>Ligji për UBO</b>	Nënkupton ligjin nr. 112/2020, "Për regjistrin e pronarëve përfitues", të ndryshuar.
<b>Ligji për Tatimin mbi të Ardhurat</b>	Nënkupton ligjin nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar.
<b>Ligji për Procedurat Tatimore</b>	Nënkupton ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

### Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit

Nënkupton ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar.

### Ligji për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve

Nënkupton ligjin nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", të ndryshuar.

### Ligji për Startup-et

Nënkupton ligjin Nr. 25/2022 "Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve", të ndryshuar

### Kodi Civil

Nënkupton Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë

### Kodi i Punës

Nënkupton Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë

### Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë

Nënkupton ligjin nr. 10237, datë 18.02.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", të ndryshuar.

### Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Nënkupton ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar

### Ligji për Pronësinë Industriale

Nënkupton ligjin nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për pronësinë industriale", të ndryshuar.

### Kodi Penal

Nënkupton ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës Së Shqipërisë", i ndryshuar.

### Ligji Për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Nënkupton ligjin Nr.10 221, datë 4.2.2010 "Për Mbrojtjen Nga Diskriminimi", i ndryshuar.

### Ligj për Barazinë Gjinore

Nënkupton ligjin Nr. 9970, date 24.07.2008 "Për Barazinë Gjinore në Shoqëri".

### Ligji për Nxitjen e Punësimit

Nënkupton ligjin Nr. 15/2019, date 13.03.2019 "Për Nxitjen e Punësimit", i ndryshuar

## Akronime

<b>DPT</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
<b>DPTTV</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore
<b>DPPI</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale
<b>KDIMDP</b>	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
<b>NUIS</b>	Numri unik i identifikimit të subjektit
<b>OJF</b>	Organizata Jofitimprurëse
<b>QKB</b>	Qendra Kombëtare e Biznesit
<b>Sh.a.</b>	Shoqëri aksionare
<b>Sh.p.k.</b>	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
<b>UBO</b>	Pronar përfitues

## Hyrje

Transformimi i përshpejtuar teknologjik ka ngritur problematika në rritje në lidhje me ndikimin e tij në punësim, me pasoja të mundshme veçanërisht për kontekste të brishta që mund të jenë më pak të pajisura për t'u përshtatur me një mjedis ekonomik me zhvillim të shpejtë. Angazhimet e OSBE-së në Dimensionin Ekonomik dhe Mjedisor (EED) bëjnë thirrje për promovimin e zhvillimit të aftësive, arsimit cilësor dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, modeleve të qëndrueshme dhe inovative të biznesit dhe kushteve të barabarta të punës, në mënyrë që të kufizohet ndikimi mundshëm i digjitalizimit në tregjet e punës dhe të mbështesë fuqizimin ekonomik të individëve, veçanërisht të grave dhe të rinjve. Në përputhje me këto angazhime dhe në mbështetje të përpjekjeve të vazhdueshme për edukim dhe inkubacion, projektit "Zhvilluesit dhe Sipërmarrësit e Rinj që Nxisin Startup-et" (YDEAS II) synon zgjerimin e mundësive për zhvillimin e aftësive dhe krijimin e vendeve të punës, përmirësimin e kushteve të punësimit së të rinjve dhe grave dhe promovimin e një mjedisi të favorshëm për sipërmarrësit e rinj, inovacione, startup-e me ndikim social dhe të gjelbër.

Hapat e parë të ushtrimit të aktivitetit të një startup-i janë vendimtare edhe në kuadër të mbarëvajtjes së mëtejshme të biznesit. Startup-et në Shqipëri hasen vazhdimisht me vështirësi në marrjen e informacionit të nevojshëm dhe gjithëpërfshirës, nga burime të sigurta e të përditësuara, lidhur me aspektet kryesore që duhen mbajtur parasysh që në momentin e themelimit dhe regjistrimit të biznesit, të cilat mund të kenë ndikim të konsiderueshëm edhe në vijimësinë e ushtrimit të aktivitetit tregtar.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, në bashkëpunim me Deloitte Legal Sh.p.k, ka përgatitur këtë udhëzues të shkurtër të kërkesave kryesore të legjislacionit të zbatueshëm në fuqi për sa i përket themelimit, regjistrimit, dhe mbarëvajtjes në hapat e parë të biznesit të një startup-i në Shqipëri. Ky dokument nuk synon të ofrojë këshillim ligjor apo fiskal lidhur me përputhshmërinë e një biznesi me kërkesat e ligjit të zbatueshëm. Qëllimi i kësaj përmbledhjeje është paraqitja në mënyrë të strukturuar e informacionit bazë ligjor si dhe e burimeve zyrtare në të cilat mund të gjendet informacion i përgjithshëm më i zgjeruar në varësi të nevojave por edhe llojin e objektit të aktivitetit të çdo startup-i.

Një vlerë e shtuar e këtij udhëzuesi është fokusi tek pajtueshmëria ligjore dhe financiare në të cilën duhet të zhvillohet ky model i ri biznesi si dhe përfshirja e një seksioni të posaçëm që lidhet me parimet kryesore të ushtrimit të veprimtarisë me integritet, duke iu përmbajtur standardeve etike dhe praktikave më të mira vendase e ndërkombëtare.

Çdo ditë bizneset përballen me sfida të reja dhe të pa njohura më parë. Lufta kunder informalitetit dhe korrupsionit mbetet prioritet, 'si fenomen i përhapur në shumë fusha të jetës publike dhe të biznesit'. Zbatimi i praktikave të konkurrencës së ndershme dhe përqaftimi i standardeve të larta etike po kthehen gjithnjë e më shumë në parime kyçe për çdo biznes. Një nga faktorët që sjell edhe nevojën për vëmendje të shtuar në aspektet e integritetit dhe etikës në biznes është edhe përhapja e përdorimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit

EC annual report on Albania (2023), pg. 4 (hyperlink) [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/ea0a4b05-683f-4b9c-b7ff-4615a5fffd0b\\_en?filename=SWD\\_2023\\_690%20Albania%20report.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/ea0a4b05-683f-4b9c-b7ff-4615a5fffd0b_en?filename=SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf)

(TIK) për qëllime operacionale dhe biznesi, duke sjellë dhe sfida sa i përket mbrojtjes së konsumatorit, të dhënave personale, etj.

Përpjekjet për një qeverisje të mirë ekonomike dhe klimë të mirë biznesi janë formësuar në një kompleks normash të krijuara si, strategji, ligje, akte të tjera, zbatimi i të cilave jo gjithmonë është i thjeshtë në praktikë. Nga ana tjetër mekanizmat vetërregullues dhe sistemi i kontrollit të përputhshmërisë ligjore ka sfidat e veta në Shqipëri; vecanerisht tek bizneset mikro dhe të vogla. Në këtë kuadër për të sensibilizuar startup-et në Shqipëri sa i përket respektimit të kërkesave ligjore, seksioni i fundit i këtij dokumenti përmban një seri pyetjesh e përgjigjesh sa i përket rasteve më të përhapura në praktikë nga bizneset. Vlen për t'u theksuar se udhëzuesi nuk synon të mbulojë aspekte specifike që lidhen me përputhshmërinë e biznesit me legjislacionin sektorial përkatës, por synon vetëm të listojë dhe udhëzojë startup-et sa i përket kuadrit ligjor e rregullator të zbatueshëm për të gjitha industritë dhe sektorët.

## Udhëzuesi

Ky udhëzues është konceptuar si një dokument praktik për të ofruar informacion të përgjithshëm të natyrës ligjore për sipërmarrësit e rinj startup-et. Udhëzuesi synon të ofrojë informacionin kryesor në lidhje me hapat e parë të themelimit dhe regjistrimit të një biznesi, si edhe zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë bazuar në standardet më të mira vendase dhe ndërkombëtare.

Pavarësisht nga sa më sipër, informacioni i përmbledhur në këtë udhëzues mund të përdoret edhe nga sipërmarrësit e rinj apo biznese tashmë të themeluara dhe që ushtrojnë aktivitetin e tyre tregtar bazuar në kuadrin ligjor shqiptar në fuqi.

Udhëzuesi është strukturuar si më poshtë:

**a)** Kreu I përmban një përmbledhje gjithëpërfshirëse të informacionit kryesor që lidhet me hapat e nevojshëm që duhen ndjekur për themelimin, regjistrimin dhe organizimin e një startup-i, në përputhje me të gjitha kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm në Shqipëri.

**b)** Kreu II përmban detyrimet kryesore ligjore të një startup-i përgjatë vijimësisë së aktivitetit tregtar duke përfshirë këtu informacionin bazë që lidhet me çështjet e punësimit, mbrojtjen e të dhënave personale.

**c)** Kreu III përmban informacionin bazë lidhur me rëndësinë e pronësisë intelektuale, si edhe përfitimet nga regjistrimi i markës tregtare të një startup-i.

**d)** Kreu IV fokusohet në trajtimin e disa detyrimeve jo shteruese lidhur me ushtrimin e aktivitetit tregtar të një startup-i me integritet dhe etikë, duke përfshirë detyrimet që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, shmangien e konfliktit të interesit, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, si edhe aspekte të tjera të ushtrimit të veprimtarisë me integritet.

**e)** Kreu V është konceptuar në formën e “pyetjeve më të shpeshta” që ngrihen nga startup-et gjatë procesit të themelimit, regjistrimit dhe hapave të parë të ushtrimit të veprimtarisë së tyre tregtare, dhe synon të paraqesë një panoramë konkrete të problematikave ligjore e rregullatorë që mund të hasin bizneset në Shqipëri.

Udhëzuesi ju drejton në faqet zyrtare të çdo institucioni ku mund të gjeni informacione më specifike në varësi të llojit të problematikës, si edhe përmban adresat kryesore në internet ku mund të gjeni aktet ligjore të përditësuara të referuara në seksionet përkatëse në dokument.

*Lutemi të mbani parasysh se ky udhëzues nuk synon të përdoret si zëvendësues i bazës ligjore të zbatueshme në Shqipëri. Disa praktika apo parashikime mund të ndryshojnë rast pas rasti në varësi të llojit të objektit të aktivitetit të ushtruar nga startup-i apo edhe rrethana të tjera. Në çdo rast, Deloitte Legal rekomandon konsultimin me një profesionist ligjor apo fiskal sipas rastit, me qëllim marrjen e këshillimit të përshtatshëm në përputhje me karakteristikat e veprimtarisë së startup-it tuaj.*

*Në vijim të sa më sipër, ky udhëzues është hartuar në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në Shqipëri deri më datën 28.02.2024.*

## I. KREU I: KRIJIMI I NJË STARTUP-I

### 1. Startup-et në Shqipëri

#### 1.1 Çfarë do të konsiderohet “startup” bazuar në Ligjin për Startup-et?

Ligji për Startup-et përcakton se me termin “startup” do të kuptohet çdo individ, person fizik ose juridik, përfshirë nomadin digjital, që synon të krijojë një **model unik biznesi**, produkt apo shërbim dhe/ose teknologji inovative **të zbatueshme në praktikë**, për përmirësimin e ndjeshëm të modeleve të biznesit, produkteve dhe shërbimeve ekzistuese, dhe që ka **potencial për rritje të shpejtë**.

Përkufizimi që jepet nga Ligji “Për Startup-et”, kërkon përmbushjen e karakteristikave e kriterëve të mëposhtme me qëllim kualifikimin e një biznesi si startup për qëllim të këtij ligji:

#### Kriteri organizativ/struktural

“individë dhe persona fizikë ose juridikë të regjistruar në regjistrin tregtar të Republikës së Shqipërisë”

#### Kriteri i objektit të aktivitetit

“janë konceptuar, krijuar dhe veprojnë me qëllim nisjen e realizimit dhe zhvillimit të një modeli biznesi, produkti dhe shërbimi inovativ dhe/ose teknologjik të veçantë, me potencial rritjeje të shpejtë, të zbatueshëm në praktikë, për përmirësimin e ndjeshëm të modeleve të biznesit, produkteve dhe shërbimeve ekzistuese.”

#### Qëllimi i Ligjit për Startup-et

Ligji për Startup-et synon të lehtësojë krijimin dhe zhvillimin e startup-eve dhe ekosistemit mbështetës si një motor i inovacionit dhe zhvillimit ekonomik duke promovuar kërkimin, realizimin dhe përdorimin e ideve inovative si dhe produkteve dhe proceseve të modeleve të reja. Në mbështetje të Ligjit për Startup-et janë miratuar nga Këshilli i Ministrave disa vendime.

#### 1.2 Si merret statusi “startup” sipas Ligjit për Startup-et?

Statusi startup merret në momentin e plotësimit të një vetëdeklarimi në regjistrin elektronik të startup-eve dhe është i vlefshëm deri në 24 muaj nga vetëdeklarimi. Menjëherë pas regjistrimit gjenerohet numri unik dhe pasaporta e startup-it.

#### 1.3 Si mund të aksesohet regjistri elektronik i startup-eve

- Regjistri elektronik i startup-eve mund të aksesohet nëpërmjet portalit e-Albania, në link-un vijues: [https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service\\_code=14900](https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14900).
- Manuali i përdorimit mund të shfletohet duke vizituar link-un vijues: [https://e-albania.al/eAlbaniaServices/MS/14900/Manual\\_Pasaporta\\_Startup.pdf](https://e-albania.al/eAlbaniaServices/MS/14900/Manual_Pasaporta_Startup.pdf)

#### 1.4 Çfarë përfitimesh rrjedhin nga regjistrimi si startup?

Ligji “Për Startup-et”, parashikon disa lehtësi duke përfshirë si vijon:

##### a. Parimi pa letër dhe me tarifa zero

Ministritë ose institucionet e tjera publike do të ofrojnë asistencë për startup-et bazuar në parimin “pa letër dhe tarifë zero”. Shërbimet që do të mundesohen pa tarifë përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

##### b. Shërbimi startup one-stop-shop

Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit në bashkëpunim me autoritetet e tjera ofrojnë shërbimin startup *one-stop-shop*, i cili përfshin:

- dhënie e informacionit mbi kuadrin rregullator ligjor në fuqi, detyrimin për t’u regjistruar në regjistrin tregtar si dhe detyrimet fiskale apo detyrime të tjera që do të zbatohen për startup-et pas periudhës së inkubimit, që nënkupton procesin e mbështetjes, përgatitjes, transformimit të idesë në model biznesi dhe i zhvillimit të një startup-i në fazën fillestare të tij;
- këshillim për mbrojtjen e të drejtave civile dhe tregtare si dhe regjistrimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale;
- organizimi i aktiviteteve informuese ndërmjet startup-eve të interesuara;
- shërbime të tjera që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Shërbimi online *one-stop-shop* mund të aksesohet duke vizituar *link*-un vijues:

<https://www.sipermarrja.gov.al/one-stop-shop/>

#### 1.5. A e dini se ka disa mënyra të mbështetjes së startup-eve?

Ligji për Startup-et parashikon format e mëposhtme të mbështetjes së startup-eve:

- shërbimi “*startup one-stop-shop*” për mbështetjen e startup-eve;
- zhvillimi i ekosistemit mbështetës për *startup*-et;
- grantet financiare ose masat e tjera mbështetëse për zhvillimin e startup-eve. Thirrjet për grante mund të gjenden ndër të tjera në faqen e Ministrisë së Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, duke vizituar këtë *link*.
- formave të tjera mbështetëse e lehtësuese të zhvilluara në bashkëpunim me palë të treta, siç përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Për të njohur më në detaje parashikimet e Ligjit për Startup-et vizitoni këtë *link*.

#### Tatimi i fitimit të bizneseve që ushtrojnë veprimtari ekonomike për prodhimin apo zhvillimin e software-ve

Gjithashtu, për personat juridikë që ushtrojnë veprimtari ekonomike për prodhimin apo zhvillimin e software-ve, deri më 31 dhjetor 2025 do të zbatohet tatimi mbi fitimin me normën 5%, bazuar në parashikimet e Ligjit për Tatimin mbi të Ardhurat.

## 2. Format e organizimit ligjor të një startup-i

Në Shqipëri, aktiviteti tregtar i një startup-i mund të organizohet në formën e një personi fizik tregtar, ose në një nga format e shoqërive tregtare të parashikuara nga Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, në varësi të kompleksitetit të veprimtarisë ekonomike që do të ushtrojë startup-i në fjalë.

### Shembull:

Në rast se ju dëshironi të ushtroni aktivitetin tuaj tregtar si profesionist i lirë (*freelance*) mund ta ushtroni atë edhe duke u regjistruar si person fizik tregtar. Në rast se do të tregtoni një produkt apo do të ofroni shërbime në bashkëpunim me disa ortakë, ose që kërkojnë organizim strukturor më të detajuar, atëherë do të rekomandohej një formë organizimi si shoqëri tregtare (forma e organizimit më e përshtatshme duhet vlerësuar rast pas rasti).

### 2.1. Çfarë është personi fizik tregtar?

Sipas Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, tregtari është personi fizik në kuptim të Kodit Civil, i cili ushtron veprimtari ekonomike të pavarur, që kërkon një organizim tregtar të zakonshëm.

### 2.2 Cilat janë detyrimet kryesore të një personi fizik tregtar?

- të regjistrohet në përputhje me parashikimet e Ligjit për Regjistrimin e Biznesit;
- tregtari përgjigjet personalisht me të gjithë pasurinë e tij të tashme dhe të ardhshme, përfshirë pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, pronësitë industriale e intelektuale, kreditë ndaj të tretëve e çdo të drejtë apo pasuri tjetër, vlera e të cilave mund të shprehet në para;
- tregtari detyrohet të ndjekë **parimet e ndershmërisë profesionale**, të zbatueshme në mjedisin tregtar ku ai vepron.

### 3. Shoqëritë tregtare

Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomike të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj. Formimi i tyre rregullohet nga [Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare](#).

Ligji shqiptar rregullon këto forma shoqërishe tregtare:

- Shoqëritë kolektive,**
- Shoqëritë komandite,**
- Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.),**
- Shoqëri aksionare (Sh.a),**

Të gjitha këto shoqëri kanë detyrimin e regjistrimit në Regjistrin Tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

### 3.1 Cila është forma më e rekomanduar e organizimit për një startup?

Format e organizimit që hasen zakonisht në Shqipëri janë person fizik tregtar dhe Sh.p.k, ose Sh.a., nëse veprimtaria ekonomike është më komplekse (rekomandohet më rrallë).

Format e organizimit të shoqërive më të përhapura në Shqipëri janë Sh.p.k dhe Sh.a pa ofertë publike, për shkak të limitimit të përgjegjësisë së ortakëve.

Sh.a. është formë organizimi më e rrallë për shkak të rregullave të ngurta në lidhje me kapitalin, qeverisjen dhe vendimmarrjen.


Në varësi të veprimtarisë ekonomike, shpeshherë është ligji i zbatueshëm ai që imponon formën e organizimit tregtar.

Biznesi mund të kryhet në formën e degëve të shoqërive të huaja. Degët janë vende biznesi që kanë të njëjtin personalitet juridik me atë të shoqërisë mëmë.

Ndërsa zyrat e përfaqësimit janë vende biznesi dhe kanë të njëjtin personalitet juridik me atë të shoqërisë – njëlloj si degët – por që nuk mund të gjenerojnë të ardhura dhe vetëm promovojnë biznesin e shoqërisë mëmë.

### 4. Themelimi dhe regjistrimi i biznesit

#### 4.1. Cilat janë hapat e themelimit dhe regjistrimit të një startup-i?



#### Si mund të themeloj një shoqëri tregtare?

Me nënshkrimin e një akti themelimi dhe statuti të shoqërisë nga të gjithë ortakët/aksionarët themelues. Në varësi të ortakëve dhe/ose organizimit të personit juridik mund të nevojiten dokumente të tjera.

#### Si mund të regjistroj një shoqëri tregtare?

- Regjistrimi kryhet *online* nëpërmjet sportelit elektronik, pranë portalit unik qeveritar [e-Albania](#), duke hapur dhe regjistruar një llogari biznesi.
- Aplikanti plotëson elektronikisht formularin dhe ngarkon dokumentet shoqëruese në format elektronik.
- Dokumentet thelbësore (pavarësisht formës së shoqërisë tregtare) janë:
  - vendimi për themelimin,
  - akti i themelimit/statuti.
- Për detaje më të hollësishme<sup>1</sup> rreth procedurave dhe veprimeve të lidhura me regjistrimin e një biznesi, lutemi të vizitoni këtë [link](#).

#### Si mund të regjistroj pronarin përfitues (UBO)?

- Aplikimi online për regjistrimin e UBO-së nga subjektet që janë regjistruar rishtazi në QKB kryhet njëkohësisht me aplikimin për regjistrimin e një shoqërie nëpërmjet portalit qeveritar [e-Albania](#).
- Për të paraqitur aplikime të vlefshme, subjektet raportuese duhet të pajisen me një [nënshkrim elektronik](#).
- Dokumentacioni i nevojshëm me qëllim identifikimin e UBO shqyrtohet rast pas rasti në varësi të strukturës organizative të shoqërisë.

#### Si mund të regjistrohem si person fizik/tregtar?

Regjistrimi kryhet *online* nëpërmjet sportelit elektronik, pranë portalit unik qeveritar [e-Albania](#), duke hapur dhe regjistruar një llogari si person fizik. Nuk kërkohen dokumentacione përveç plotësimit të formularit përkatës në portal. Aplikimi kryhet duke vizituar këtë [link](#).

<sup>1</sup> Në këtë udhërrëfyes është bere një përmbledhje e procedurave kryesore. Në varësi të llojit të organizimit të personit juridik tregtar mund të ndryshojë edhe dokumentacioni.



Si mund të regjistrohem për të marrë statusin e "startup-it"?

- ❑ Regjistri elektronik i startup-eve mund të aksesohet nëpërmjet portalit e-Albania, në *link-un* vijues: [https://e-albania.al/eAlbania-Services/UseService.aspx?service\\_code=14900](https://e-albania.al/eAlbania-Services/UseService.aspx?service_code=14900).
- ❑ Manuali i përdorimit mund të shfletohet duke vizituar *link-un* vijues: [https://e-albania.al/eAlbaniaServices/MS/14900/Manual\\_Pasaporta\\_Startup.pdf](https://e-albania.al/eAlbaniaServices/MS/14900/Manual_Pasaporta_Startup.pdf)

Kur dhe si duhet të licencoj shoqërinë?<sup>2</sup>

Liçensimi kryhet në rastet kur aktiviteti ekonomik bie në një nga kategoritë për të cilat kërkohet liçensim, siç përcaktohet rast pas rasti në ligjin e zbatueshëm. Për më shumë informacion lidhur me lejet dhe licencat që mund të nevojiten për biznesin, vizitoni *link-un* vijues: <https://qkb.gov.al/informacion-mbi-procedur%C3%ABn/regjistr-i-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/informacion-mbi-licens-at-autorizimet-dhe-lejet/>

#### 4.2. Detyrimi për Identifikimin e Pronarit Përfitues (UBO)

Ligji për UBO përcakton detyrimin që çdo shoqëri tregtare dhe degë duhet të identifikojë dhe regjistrojë në përputhje me kërkesat e ligjit të zbatueshëm UBO të subjektit juridik të sapoformuar, pranë autoriteteve shqiptare.

Ligji e përkufizon UBO-n si individ që në fund zotëron ose kontrollon një person juridik, nëpërmjet pronësisë direkte ose indirekte të 25% të kuotave/aksioneve ose të drejtave të votës ose interesave pronësore në atë entitet, ose nëpërmjet kontrollit me anë të mjeteve të tjera.

##### *Përse është i rëndësishëm identifikimi dhe regjistrimi i UBO?*

Njohja e UBO-së është thelbësore për ruajtjen e transparencës dhe integritetit në marrëdhëniet e biznesit. Njohja e UBO-së ndihmon në parandalimin e pastrimit të parave, mashtrimit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme duke siguruar që të identifikohen pronarët e vërtetë të një shoqërie dhe të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre.

Për këtë qëllim, Ligji për UBO ka parashikuar identifikimin dhe regjistrimin e UBO-je si një detyrim për çdo shoqëri tregtare.

Aplikimi online për regjistrimin e UBO-së nga subjektet që janë regjistruar rishtazi në QKB kryhet njëkohësisht me aplikimin për regjistrimin e një shoqërie nëpërmjet portalit qeveritar [e-Albania](https://e-albania.al).

Për të paraqitur aplikime të vlefshme, subjektet raportuese duhet të pajisen me një [nënshkrim elektronik](#).

Dokumentacioni i nevojshëm me qëllim identifikimin e UBO-së shqyrtohet rast pas rasti në varësi të strukturës organizative të shoqërisë.

#### 4.3. Cilat janë regjistrimet e nevojshme pranë organeve tatimore

Regjistrimi në QKB shërben njëkohësisht si regjistrim në tatime, në skemat e sigurimit, shoqëror dhe shëndetësor në inspektoratet e punës dhe organet doganore. QKB, përcakton NUIS-in dhe ju pajis me Certifikatën e Regjistrimit, si për adresën kryesore dhe për adresën dytësore.

Sipas [Ligjit për Procedurat Tatimore](#), tatimpaguesit e rinj janë të detyruar të hapin llogarinë bankare të biznesit jo më vonë se 20 ditë kalendarike nga e nesërmja e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit/Administratën Tatimore dhe ta deklarojnë atë në të njëjtën mënyrë në Administratën Tatimore. Në rast të mos përmbushjes së detyrimit, ligji parashikon sanksione për tatimpaguesit.

Gjithashtu, çdo subjekt taksapagues ka detyrimin ligjor që të regjistrohet për pagesën e taksave vendore në përputhje me kërkesat e ligjit të zbatueshëm.

<sup>2</sup> Nuk janë përfshirë këtu rastet e sektorëve specifikë, si për shembull institucione financiare, etj.

## II. Kreu II: Përmbushja e detyrimeve ligjore në vijmësi (compliance)

### 1. Si mund të garantohet përputhshmëria me kuadrin ligjor të zbatueshëm (compliance)?

Përputhshmëria me kuadrin ligjor të zbatueshëm konsiston në një përpjekje të vazhdueshme dhe vëmendje konstante të startup-it ndaj ndryshimeve dhe përditësimeve të kuadrit rregullator me qëllim garantimin e zbatimit të dispozitave ligjore për shmangien e penalteteve.

Përmbushja e detyrimeve ligjore jo vetëm garanton kryerjen e aktivitetit tregtar me integritet por edhe ndihmon startup-in për të shmangur sanksionet, konfliktet e mundshme gjyqësore, por edhe probleme si dëmi ndaj reputacionit, besueshmëria në treg, përfitim nga grantet, etj.

Të gjitha tematikat e trajtuara në udhëzues konsistojnë në detyrime esenciale për t'u përmbushur nga startup-et me qëllim ushtrimin e veprimtarisë me integritet dhe në zbatim të kuadrit ligjor përkatës.

### 2. Çështje të punësimit

#### 2.1. Përse është e rëndësishme njohja e legjislacionit të punës?

Baza kryesore ligjore që rregullon marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë është Ligji nr. 7961 datë 12.07.1995 "[Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë](#)" i ndryshuar ("[Kodi i Punës](#)"), si edhe aktet nënligjore të lëshuara në mbështetje të tij. Aspekte specifike të punësimit si punësimi i të huajve, sinjalizimi, shëndeti dhe siguria në punë rregullohen me ligje të veçanta.

Njohja e legjislacionit të punës është një nga aspektet kryesore për mirë funksionimin e një startup-i, lidhur kjo jo vetëm me përmbushjen e detyrimeve ligjore, por edhe ushtrimin e aktivitetit tregtar me integritet.

*Trajtimi i drejtë i punëmarrësit:* Legjislacioni i punës në Republikën e Shqipërisë mbron punëmarrësin si palën më të dobët në marrëdhënien e punës duke ngarkuar punëdhënësin me disa detyrime për të garantuar trajtimin e drejtë të punëmarrësve.

Trajtimi i punëmarrësve në mënyrë të drejtë dhe në mënyrë të barabartë është një manifestim i integritetit në vendin e punës.

*Informacion i nevojshëm në mbrojtjen e interesave:* Integriteti përfshin komunikim të ndershëm dhe të hapur. Njohja e legjislacionit të punës shërben për njohjen e të drejtave dhe detyrave qoftë të punëdhënësit por edhe punëmarrësit. (Legjislacioni i punës kërkon nga punëdhënësit të japin informacion të saktë dhe të plotë për punëmarrësit në lidhje me të drejtat, përfitimet dhe kushtet e tyre të punës).

*Shmangia e sanksioneve dhe respektimi i detyrimeve të kontratës së punës:* Kontrata e punës është përbërësi thelbësor i marrëdhënies së punës. Respektimi i kushteve në këto kontrata, por edhe legjislacionin e aplikueshëm, tregon integritet nga ana e punëdhënësit si edhe ndihmon në shmangien e gjobave të vendosura nga autoritetet përkatëse por edhe të dëmshpërblimeve të kërkuara nga punëmarrësit në gjykatat përkatëse.

Mbështetja e parimeve si më sipër, por pa u kufizuar vetëm në to, siguron që punëmarrësit të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe pa paragjykime duke kontribuar në një kulturë të vendit të punës të bazuar në integritet. Në thelb, legjislacioni i punës siguron një kornizë për sjellje të drejtë dhe etike përgjatë marrëdhënies së punës.

#### 2.2. Çfarë duhet të kenë parasysh startup-et lidhur me procedurat e rekrutimit?

Një aspekt shumë i rëndësishëm për fillimin e marrëdhënies së punës është edhe procesi i rekrutimit si pikënisja e marrëdhënies (së mundshme) të punës.

Kodi i Punës nuk bën parashikime të veçanta në lidhje me procesin e rekrutimit, por pavarësisht mungesës së rregullave të detajuara dhe të qarta, disa aspekte të procesit të rekrutimit mbrohen nga Kodi i Punës dhe ligje të veçanta.

Më poshtë kemi trajtuar disa aspekte, të cilat duhet të merren parasysh jo vetëm për një proces rekrutimi të suksesshëm por edhe të realizuar me integritet.

**Vërtetësia në përshkrimet e punës:** Integriteti në rekrutim fillon me hartimin e përshkrimeve të sakta të punës. Përshkrimi i pozicionit të punës me saktësi siguron që kandidatët e mundshëm të kenë një kuptim të qartë të asaj që pritet, duke nxitur besimin që në fillim.

**Praktikat e rekrutimit të drejta dhe jo diskriminuese:** Ruajtja e drejtësisë gjatë gjithë procesit të rekrutimit është një aspekt kryesor i integritetit. Kjo përfshin mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët, vendimmarrje të paanshme dhe aderimin ndaj [ligjeve kundër diskriminimit](#), si edhe parashikimeve të Kodit të Punës që synojnë mbrojtjen nga diskriminimi.

**Komunikimi transparent:** Mbajtja e kandidatëve të informuar në lidhje me procesin e rekrutimit, afatet kohore dhe statusin e aplikimit të tyre kontribuon në një përvojë transparente dhe të besueshme.

**Ruajtja e konfidencialitetit dhe mbrojtja e të dhënave personale:** Respektimi i konfidencialitetit të kandidatëve është një aspekt thelbësor i integritetit. Trajtimi i informacionit personal në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm dhe marrja e pëlqimit për kontrolle demonstroi një angazhim për zhvillimin e praktikave etike të rekrutimit.

**Konsistenca në vlerësim:** Startup-i si punëdhënës që zbaton rregulla të integritetit në rekrutim duhet të tregojë qëndrueshmëri në vlerësimin e kandidatëve bazuar në meritë, aftësi dhe kualifikime, shmangien e favorizimit ose paragjykimave në procesin e përzgjedhjes.

**Trajtimi etik i punëmarrësve që largohen:** Në rastet kur rekrutimi përfshin zëvendësimin e një punëmarrësi ekzistues, integriteti lidhet me trajtimin e punëmarrësit që largohet me respekt dhe me etikë, duke shmangur çdo praktikë të padrejtë duke u fokusuar këtu edhe në zbatimin e proceduarve ligjore në lidhje me shkëputjen e marrëdhënies së punës.

### 2.3. Si fillon marrëdhënia e punës?

Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës, punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim.

Kontrata e punës quhet e lidhur kur punëmarrësi pranon kryerjen e një pune ose shërbimi, për një periudhë kohe të caktuar ose të pacaktuar, brenda kuadrit të organizimit dhe sipas urdhrave të punëdhënësit dhe që, në bazë të këtyre rrethanave, kryhet vetëm kundrejt pagesës. Kontrata e punës duhet të jetë me shkrim dhe të nënshkruhet me fillimin e marrëdhënies së punës; në rrethana të jashtëzakonshme kontrata e punës do të lidhet me shkrim brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e fillimit të marrëdhënies së punës.

### 2.4. A e dini se ka disa lloje të kontratave të punës që mund të nënshkruhen me punëmarrësin?

- *Kontrata e Punës me afat të caktuar* duhet të aplikohet vetëm në raste përjashtimore dhe të justifikohet për arsye objektive që legjitimojnë nevojën e lidhjes së kontratës me afat të caktuar.
- *Kontrata e Punës me afat të pacaktuar* është forma standarde dhe më e përdorur e kontratës.
- *Kontrata e Punës me kohë të plotë* është kontratë në të cilën punëmarrësi është në dispozicion të punëdhënësit me kohë të plotë, zakonisht 8 orë pune.
- *Kontrata e Punës me kohë të pjesshme* ka kohë pune më të shkurtër se ajo me kohë të plotë.

### 2.5. Çfarë elementesh kryesore duhet të përmbajë kontrata e punës në mënyrë që të shmangen sanksionet e mundshme nga Inspektorati i Punës?

Kontrata e punës duhet të përmbajë të paktën dispozitat e mëposhtme:

- a) identitetin e palëve;
- b) vendin e punës;
- c) përshkrimin e përgjithshëm të punës;
- d) datën e fillimit të punës;
- e) kohëzgjatjen, kur palët lidhin kontratë me afat të caktuar;
- f) kohëzgjatjen e pushimeve të paguara;
- g) afatin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës;
- h) elementet përbërëse të pagës dhe datën e dhënies së saj;
- i) kohën normale javore të punës;
- j) referenca në kontratën kolektive në fuqi;
- k) periudhën e provës;
- l) llojet dhe procedurat e masave disiplinore, nëse nuk ka kontratë kolektive.

### 2.6. Trajtimi i punëmarrësit me integritet

Trajtimi i punëmarrësit me integritet paraqet një larmishmëri detyrimesh dhe modele sjelljesh nga ana e punëdhënësit siç janë detajuar në këtë manual në seksione të ndryshme por jo më pak të rëndësishme janë detyrimet që lidhen me trajtimin e barabartë, ndalimin e diskriminimit dhe barazinë gjinore.

#### A e dini se legjislacioni shqiptar ka dispozita të detajuara të cilat ndalojnë diskriminimin në punësim (dhe jo vetëm)?

Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë parashikon se me **"diskriminim"** kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.

#### Diskriminimi ndalohet me ligj dhe është subjekt penalitetesh!

Parimi si më sipër, ka edhe përjashtime. Dallimet, kufizimet, përjashtimet ose parapëlqimet, që bazohen në një karakteristikë të lidhur me shkaqet e përmendura si më sipër nuk përbëjnë diskriminim kur, për shkak të natyrës së aktiviteteve profesionale, ose të kushteve në të cilat profesioni ose veprimtaria ushtrohet, këto karakteristika përbëjnë një kërkesë të vërtetë dhe profesionale të domosdoshme, me kusht që qëllimi i trajtimit të ndryshëm të jetë i përligjur dhe kërkesa të mos kapërcejë atë çfarë është e domosdoshme për realizimin e saj.

Në rastin kur një person pretendon se është cenuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, sipas këtij Kodi, ndiqet procedura e ankimit, e përcaktuar në [ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi](#).

Sipas [ligjit për barazinë gjinore](#), ju si punëdhënës mund të vendosni kuota gjinore për të rritur balancën e përfaqësimit të dy gjinive në vendin e punës. Për të siguruar përfaqësim të barabartë në

fushën e marrëdhënieve të punës, në procesin e përzgjedhjes për marrjen në punë, ngritjen në detyrë, zhvillimin e aftësive profesionale, kur kandidatët kanë rezultate ose nivele të barabarta, punëdhënësi i jep përparësi kandidatit të gjinisë më pak të përfaqësuar. Kjo nuk do të konsiderohet si diskriminim.

### **Cilat janë detyrimet e një startup-i në lidhje me nxitjen e punësimit të disa kategorive të veçanta punëmarrësish?**

Me qëllim garantimin e parimeve të mosdiskriminimit si edhe ofrimin e mundësisë së punësimit grupeve të veçanta (të disavantazuara) [ligji për nxitjen e punësimit](#) parashikon disa programe për nxitjen e punësimit të këtyre grupeve.

Çdo shoqëri ka detyrimin të ketë një numër proporcional të punësuarish *“persona me aftësi të kufizuara, përfshirë personat që nuk dëgjojnë dhe invalidët e punës të vlerësuar pjesërisht të aftë për punë nga komisionet përkatëse”* me punëmarrësit e zakonshëm, ose të paguajë kontribute për llogari të Fondit Social të Punësimit n.q.s. një punësim i tillë nuk është i mundur.

- Për shoqëritë deri në 25 punëmarrës, punëdhënësi duhet të punësojë te paktën 1 person që bën pjesë në grup të veçantë.
- Për shoqëritë me më shumë se 25 punëmarrës, për çdo 50 nëpunës shtesë, duhet të punësohet nga 1 person nga grupet e veçanta.
- Punëdhënësi, i cili nuk punëson numrin e përcaktuar të personave, duhet të derdhë një kontribut për llogari të Fondit Social të Punësimit në masën e pagës minimale në shkallë vendi për çdo muaj për çdo person që i përket grupeve të veçanta që ai duhet të kishte punësuar.

Pagesa e këtij kontributi bëhet nëpërmjet dorëzimit të listë pagesave mujore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në rolin e Agjentit, do të monitorojë pagesën e këtyre kontributeve.

### **Ndalimi i ngacmimit moral dhe seksual në vendin e punës!**

Çdo startup duhet të mbajë parasysh se në rolin e punëdhënësit jo vetëm që duhet të promovojë ndalimin e ngacmimit moral dhe seksual të punëmarrësve por duhet edhe të marrë masa si edhe të raportojë shkeljet (në rast se ka).

Kodi i Punës parashikon se punëdhënësi ka detyrimin të respektojë dhe të mbrojë në raportet e punës personalitetin e punëmarrësit, si dhe:

- a) merr të gjitha masat e nevojshme për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit mendor dhe fizik të punonjësve;
- b) merr të gjitha masat e nevojshme për të ndaluar ngacmimin moral të kryer prej tij dhe nga punonjësit e tjerë, si dhe afishon dispozitat mbi ngacmimin moral dhe seksual dhe sanksionet përkatëse;
- c) parandalon çdo qëndrim që cenon dinjitetin e punëmarrësit.

Ngacmimi seksual është gjerësisht i rregulluar edhe nga [Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë](#) i cili parashikon se kryerja e sjelljeve me natyrë seksuale, që cenojnë dinjitetin e një personi, me çdo mjet ose formë, duke krijuar një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

### **2.7. A e dini çfarë do të konsiderohen si orë pune shtesë?**

Kohëzgjatja ditore e punës nënkupton kohën e përditshme efektive e punës nga ora 0 deri në orën 24:00

të së njëjtës ditë, pa përfshirë pushimet. Kohëzgjatja ditore normale e punës është jo më shumë se 8 orë.

Me kohëzgjatje javore të punës kuptohet koha e punës e kryer nga e hëna në mëngjes ora 0 deri të dielën e ardhshme ora 24:00. Kohëzgjatja normale e javës së punës është jo më shumë se 40 orë.

Me orë shtesë kuptohet çdo orë pune e kryer mbi kohëzgjatjen ditore normale ose javore maksimale të punës.

*! Punëdhënësi mund të kërkojë kryerjen e orëve shtesë të punës, por jo më shumë se 200 orë në vit.*

*! Nuk mund të kërkohet kryerja e orëve shtesë javore kur punëmarrësi ka kryer 48 orë pune në javë.*

### **2.8. Leja e lindjes dhe përfitimet**

Kodi i Punës reflekton një përjasje të qartë dhe të detajuar ndaj mbrojtjes së të drejtave të grave shtatzëna dhe nënave të reja në vendin e punës, duke synuar të mbështesë jo vetëm shëndetin e nënës dhe të fëmijës, por edhe të promovojë barazinë në punësim dhe ekuilibrin midis jetës profesionale dhe asaj familjare.

Ndalohet puna për gratë shtatzëna 35 ditë para lindjes dhe 63 ditë pas lindjes. Kur gruaja shtatzënë ka në barrë më shumë se një fëmijë, periudha e parë bëhet 60 ditë. Pas periudhës 63-ditore të paslindjes, gruaja vendos vetë nëse dëshiron të punojë ose të përfitojë nga sigurimet shoqërore.

Neni 105 i Kodit të Punës përcakton të drejtat e grave në lidhje me lejen e lindjes, duke u ofruar atyre një periudhë të paguar leje që përcaktohet nga [Ligji për Sigurimet Shoqërore](#).

E ardhura për barrëlindje i paguhet gruas së siguruar për barrën dhe lindjen e fëmijës, kur ajo ka 12 muaj periudhë sigurimi, për çdo rast përfitimi. Periudha e përfitimit do të jetë 365 ditë kalendarike.

Legjislacioni shqiptar në përgjithësi, duke synuar të mbrojë jetën familjare, i jep disa benefite nënave të reja duke përfshirë këtu pushime ditore, pushime të paguara dhe të papaguara për tu kujedur për fëmijët e mitur etj.

### **2.9. Kompensimi i orëve të punës shtesë**

#### **Orë pune shtesë:**

Paga normale dhe një shtesë jo më pak se 25 për qind të saj **ose** me një pushim të paktën 25 për qind më të madh, që i korrespondon kohëzgjatjes së orëve shtesë dhe që jepet brenda 2 muajve nga dita e kryerjes së punës.

#### **Orët shtesë të punës të kryera gjatë pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare:**

Pushim **ose** pagë të paktën 50 për qind më të madhe se orët shtesë të bëra ose paga normale.

#### **Puna e kryer në ditën e pushimit javor:**

Shtesë page, jo më pak se 25 për qind, **ose** me një pushim të pagueshëm, të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer plus një pushim shtesë, jo më pak se 25 për qind të kohëzgjatjes së kësaj pune.

#### **Puna e kryer në ditët e festave zyrtare, kur ato bien ditë pune:**

Shtesë mbi pagë, jo më pak se 25 për qind **dhe** me një pushim të pagueshëm, të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer në ditët e festave zyrtare.

#### **Orë pune e kryer nga ora 19:00 deri në 22:00:**

Shtesë mbi pagë jo më pak se 20 për qind.

**Orë pune e kryer midis intervalit 22:00 dhe 6:00:**

Shtesë mbi pagë jo më pak se 50 përqind.

**2.10. Kur dhe si mund të zgjidhet kontrata e punës?**

Kontrata e punës përfundon kur:

- a) Mbaron afati;
- b) Me zgjidhje të njëanshme;
- c) Marrëveshje mes palëve;
- d) Vdekja e punëmarrësit
- e) Raste të tjera të përcaktuara në ligj ose në kontratë.

**!** Punëdhënësi mund të zgjidhi kontratën e punës vetëm për shkaqe si **aftësia, sjellja e punëmarrësit ose kërkesat operacionale të ndërmarrjes** dhe ka përfunduar afati i njoftimit.

**2.11. Cilat janë hapat që duhet të ndjek si punëdhënësi nëse kam vendosur të zgjidh kontratën e punës me një punëmarrës?**

<b>Hapi 1:</b>	Punëdhënësi njofton me shkrim punëmarrësin të paktën 72 orë përpara takimit për të biseduar me të.
<b>Hapi 2:</b>	Punëdhënësi, gjatë bisedës, i parashtron punëmarrësit arsyet e vendimit të parashikuar për t'u marrë dhe i jep atij mundësi për t'u shprehur.
<b>Hapi 3:</b>	Zgjidhja njoftohet me shkrim, brenda një afati nga 48 orë deri në një javë pas takimit. Në njoftimin me shkrim, punëdhënësi përcakton arsyet e zgjidhjes së kontratës, të cilat lidhen me shkaqe të tilla si aftësia, sjellja e punëmarrësit ose kërkesat operacionale të ndërmarrjes.

**Vini re: ju duhet në çdo rast të respektoni afatet e mëposhtme:**

Në bazë të nenit 143 të Kodit të Punës, secila palë duhet të njoftojë palën tjetër për zgjidhjen e kontratës së punës me kohëzgjatje të pacaktuar të paktën brenda afateve të mëposhtme:

- Gjatë kohës së marrjes në provë, secila nga palët mund të zgjidhë kontratën duke i njoftuar vendimin e saj palës tjetër të paktën 5 ditë përpara.
- Kur marrëdhënia e punës ka zgjatur deri në 6 muaj afati i njoftimit është dy javë.
- Kur marrëdhënia e punës ka zgjatur nga 6 muaj deri në 2 vjet afati i njoftimit është 1 muaj.
- Kur marrëdhënia e punës ka zgjatur nga 2 deri në 5 vjet afati i njoftimit është 2 muaj.
- Kur marrëdhënia e punës ka zgjatur mbi 5 vjet afati i njoftimit është 3 muaj.

**Cila është procedura që duhet ndjekur nëse kam vendosur të largoj një punëmarrës nëpërmjet zgjidhjes së menjëhershme të kontratës së punës?**

Secila nga palët në kontratën e punës mund të përfundojë në çdo kohë në mënyrë të menjëhershme kontratën për shkaqe të justifikuara, të cilat nuk lejojnë vazhdimin e marrëdhënies së punës në bazë të parimit të mirëbesimit.

Përfundimi i marrëdhënies së punës me efekt të menjëhershëm ndodh vetëm nëse ekzistojnë shkaqe të justifikuara, si shkelja e rëndë ose me faj të lehtë në mënyrë të përsëritur e dispozitave kontraktuale nga ana e punëmarrësit.

Gjykata është institucioni që vendos nëse këto shkaqe të justifikuara ekzistojnë dhe kjo e fundit do të shqyrtojë rast pas rasti shkaqe të tilla.

Informacione të mëtejshme në lidhje me punësimin mund të gjenden në faqen zyrtare të [Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive](#) si edhe [Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore](#)

Moszbatimi i dispozitave të legjislacionit të punës bëhet shkak për aplikimin e penaliteteve në disa shumëfish të pagës minimale.

**2.12. A e dini se disa detyrime duhet të zbatohen edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës?**

**Ruajtja e konfidencialitetit**

Gjatë vlefshmërisë së kontratës dhe pas mbarimit të saj, punëmarrësi duhet të ruajë faktet e destinuar të mbeten sekret si sekretet e fabrikimit dhe i veprimtarisë, që ai ka pasur dijeni kur ka qenë në shërbim të punëdhënësit.

Kontrata e Punës mund të parashikojë detyrime të qarta në lidhje me mbrojtjen e konfidencialitetit dhe sekretit tregtar.

Punëmarrësi përgjigjet ndaj punëdhënësit për dëmin që i shkakton kur shkel detyrimet kontraktuale me dashje ose nga pakujdesia.

**Mbrojtja e konkurrencës**

Gjatë vlefshmërisë së kontratës, punëmarrësi nuk duhet të kryejë asnjë punë të paguar nga të tretët, e cila dëmton punëdhënësin ose i bën konkurrencë atij.

Punëmarrësi mund të zotohet me shkrim që pas përfundimit të marrëdhënies së punës, nuk do t'i bëjë punëdhënësit konkurrencë në asnjë lloj mënyre.

Marrëveshja për ndalimin e konkurrencës është e vlefshme vetëm nëse raportet e punës i kanë dhënë mundësinë punëmarrësit të ketë dijeni për sekretet e fabrikimit ose të veprimtarisë së punëdhënësit dhe nëse përdorimi i këtyre sekreteve mund t'i shkaktojë punëdhënësit një dëm të rëndë.

Punëdhënësi mund të kërkojë zbatimin e marrëveshjes për ndalimin e konkurrencës vetëm nëse i ofron punëmarrësit, gjatë periudhës së ndalimit, jo më pak se 75 përqind të pagës që ai do të merrte po të vazhdonte të punonte për punëdhënësin.

**2.13. A e dini se ju si punëdhënësi keni disa detyrime në kuadër të garantimit të sigurisë dhe shëndetit në punë?**

Baza kryesore që rregullon çështje të sigurisë dhe shëndetit në punë është Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

Integrimi i praktikave të shëndetit dhe sigurisë në punë në strukturën e startup nuk është vetëm një domosdoshmëri ligjore, por edhe detyrim moral. Garantimi i sigurisë dhe shëndetit në punë reflekton një

angazhim për të trajtuar drejtësisht punëmarrësit, duke kontribuar në një kulturë në vendin e punës të bazuar në integritet.

Detyrimet e punëdhënësit sipas Ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë përfshijnë:

- ✓ Vlerësimin e rrezikut në vendin e punës,
- ✓ Informimin e punëmarrësve në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në punë, vlerësimin e riskut;
- ✓ Mundësimin e trajnimeve të vazhdueshme për punëmarrësit;
- ✓ Përmirësimin dhe marrjen e masave për minimizimin e rrezikut;
- ✓ Monitorim i zbatimit të masave mbrojtëse;
- ✓ Raportim i aksidenteve në vendin e punës.

Punëdhënësi duhet të kujdeset veçanërisht për:

- ✓ Higjienën dhe përshtatshmërinë e vendeve të punës.
- ✓ Marrjen e masave të nevojshme mbrojtëse kundër rreziqeve të veçanta që paraqesin substancat dhe agjentët helmues, makinat, transporti i peshave të rënda, ndotja e ajrit, zhurmat dhe dridhjet, si dhe rreziqeve në disa degë të ekonomisë, si ndërtim, xhenio civile, miniera dhe industri kimike.
- ✓ Vendosjen e sinjaleve të dallueshme qartë në çdo vend pune, që paraqet rrezik për jetën dhe shëndetin e punëmarrësve.
- ✓ Mbrojtjen nga zjarri, vendosjen e mjeteve fikëse, organizimin e trajnimeve vjetore.
- ✓ Hartimin e dokumentit për vlerësimin e riskut.
- ✓ Marrjen e masave dhe organizimin e trajnimeve për ndihmën e shpejtë.
- ✓ Mbajtjen në përputhje me ligjin të regjistrimit të aksidenteve në punë.

Në varësi të llojit të aktivitetit dhe numrit të punëmarrësve, punëdhënësi duhet të emërojë personat përgjegjës për çështje të sigurisë dhe shëndetit në punë, Këshillin e Sigurisë në Punë, mjekun e punës.

Ju mund të gjeni më shumë informacione për çështje të sigurisë dhe shëndetit në punë pranë autoritetit përgjegjës inspektues, [Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore](#).

### 3. Përbushja e detyrimeve të legjislacionit tatimor<sup>3</sup>

Njohja e legjislacionit tatimor është një nga aspektet më të rëndësishme të garantimit jo vetëm të ushtrimit të aktivitetit tregtar me integritet, por edhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ju duhet të mbani parasysh se Republika e Shqipërisë aplikon një sërë taksash dhe tatimesh dhe mos përbushja e detyrimeve tatimore mund të bëhet shkak për vendosjen e sanksioneve si edhe mos ushtrimin e aktivitetit tregtar.

Vlen për t'u theksuar se marrëdhënia e punës si edhe aktiviteti tregtar janë subjekt tatimi dhe i deklarimeve përkatëse në përputhje me ligjin tatimor.

<sup>3</sup> Informacioni i paraqitur në këtë seksion nuk është shterues sa i përket detyrimeve tatimore të një biznesi. Ju duhet në çdo rast të konsultoheni me një ekspert fiskal për të identifikuar të gjitha detyrimet e zbatueshme ndaj aktivitetit tuaj. Mbani parasysh se legjislacioni tatimor është subjekt ndryshimesh të herëpashershme. Informacion më të detajuar sa i përket legjislacionit tatimor mund të gjeni duke vizituar [link: https://www.tatime.gov.al/c/6/legjislacioni](https://www.tatime.gov.al/c/6/legjislacioni).

#### 3.1. Kur dhe si duhet t'i deklaroj punëmarrësit pranë organeve tatimore?

- ✓ Punëmarrësit regjistrohen të paktën 1 (një) ditë kalendrike para fillimit të punës;
- ✓ Administratorët të deklarohen të paktën 2 ditë pune pas regjistrimit në QKB;
- ✓ Bëhet largimi të paktën brenda 10 (dhjetë) ditë kalendrike pas përfundimit të marrëdhënies së punës.

Deklarimi i punëmarrësve bëhet në portalin "e-tax".

#### 3.2. Si bëhet përlogaritja dhe deklarimi i kontributeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore?

! Nëse ju jeni një startup që ka punësuar individë, në rolin e punëmarrësit keni detyrimin të kryeni deklarimet e mëposhtme:

##### Përlogaritja për punësimin me kohë të plotë:

- kohë të plotë – 160 orë në muaj/ 40 orë në javë;
- kohë të plotë - më shumë se 87 orë në muaj

##### Përlogaritja për punësimin me kohë të pjesshme:

- me më pak se 87 orë në muaj;
- Normat për sigurimet shoqërore janë 13.92% dhe 9.38% përkatësisht për punëdhënësin dhe punëmarrësin dhe sigurime shëndetësore 3.4%.

##### Mbi pagën bruto dhe shtesat me natyrë të përhershme, brenda kufijve min-max:

- 40 000 Lekë paga minimale dhe 176 416 Lekë paga maksimale në shkallë vendi për efekte të kontributeve shoqërore;
- Normat për sigurimet shoqërore janë 15% dhe 9.5% përkatësisht për punëdhënësin dhe punëmarrësin dhe sigurimet shëndetësore 3.4%.

Natyra e punësimit	Përlogaritja				
	Paga bruto ne ALL	Punëdhënësi		Punëmarrësi	
		Sig. shoq (15%)	Sig. shend (1.7%)	Sig. shoq (9.5%)	Sig. shend (1.7%)
Kohë e plotë/ pjeshme me më shumë se 87 orë	paga bruto ≤ 40 000	40 000*15%	40 000*1.7%	40 000*9.5%	40 000*1.7%
	40 000 ≤ paga bruto ≤ 176 416	paga bruto *15%	paga bruto *1.7%	paga bruto *9.5%	paga bruto *1.7%
	paga bruto ≥ 176 416	176 416 *15%	paga bruto *1.7%	176 416 *9.5%	paga bruto *1.7%

### 3.3. Si taten të ardhurat personale nga punësimi?

Të ardhurat nga punësimi (TAP) do të taten në përputhje me skemën progresive përmes deklaratës së listëpagesës:

E ardhura nga paga në lekë /muaj		E ardhura e tatueshme në leke/muaj		Norma tatimore në përqindje/mujore
Nga	Deri ne	Nga	Deri ne	
0	50 000	0	50 000	0%
50 001	60 000	0	35 000	0%
		35 001	60 000	13% të shumë s mbi 35 000 lekë
60 001	Më tepër	0	30 000	0%
		30 001	200 000	13% e shumë s mbi 30 000 lekë
		200 001	Më tepër	22 100 leke + 23% të shumë s mbi 200 000 lekë

Nga 1 Janar 2025, Normat e tatimit mbi të ardhurat personale janë:

- Të ardhurat nga punësimi taten sipas skemës progresive si më poshtë:

E ardhura vjetore nga paga në lekë	Tatimi sipas skemes progresive
0 – 2,040,000	13%
Mbi 2,040,000	23%

Tatimpaguesi i të ardhurave personale me të ardhura nga punësimi dhe/ose biznesi mund të zbrësë nga baza tatimore për periudhën tatimore zbritjet personale si vijon:

E ardhura vjetore nga paga në lekë	Zbritja vjetore në lekë	E ardhura mujore nga paga në lekë	Zbritja mujore në lekë
0 – 600,000	600,000	0 – 50,000	50,000
600,000 – 720,000	420,000	50,000 – 60,000	35,000
Mbi 720,000	360,000	Mbi 60,000	30,000

**! Vini re: ju duhet të respektoni afatet ligjore të dorëzimit si më poshtë:**

#### Punëdhënësit dhe të vetë-punësuarit:

- Dorëzojnë në e-tax listëpagesën brenda datës 20 të muajit pasardhës (ose në çdo 3 muaj në rastin e të vetë-punësuarit);
- Paguajnë kontributet shoqërore e shëndetësore brenda datës 20 të muajit pasardhës (ose në çdo 3 muaj në rastin e të vetë-punësuarit).

### 3.4. Cilat janë detyrimet e një startup-i lidhur me hartimin dhe deklarimin e pasqyrave financiare?

Tregtarët dhe shoqëritë tregtare kane detyrimin të mbajnë libra kontabël, të hartojnë e publikojnë të dhënat financiare dhe raportet për gjendjen e ecurisë së veprimtarisë, përfshirë dhe raportet e kontrollit të ekspertëve kontabël të autorizuar në përputhje me Ligjin Nr. 25/2018 për "Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Në fund të çdo viti financiar, shoqëria përgatit pasqyrat vjetore financiare, ku përcaktohen fitimi dhe humbja, si dhe pjesa që i përket në to secilit ortak. Pasqyrat financiare hartohen sipas standardeve kontabël (kombëtare dhe ndërkombëtare) dhe paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar të shoqërisë, performancën financiare, ndryshimet në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të shoqërisë.

Zakonisht kohëzgjatja e periudhës raportuese të pasqyrave është 12 muaj, duke filluar nga data 1 janar dhe përfunduar në datën 31 dhjetor. Kjo kohëzgjatje mund të jetë më e shkurtër ose më e gjatë, në varësi të fillimit të aktivitetit financiar të shoqërisë, por, gjithsesi, nuk mund të jetë më e shkurtër se 3 muaj dhe më e gjatë se 15 muaj. Dokumentet kontabël ruhen në selinë ku zhvillohet aktiviteti ekonomik i shoqërisë për të paktën 10 vjet rresht pas mbylljes së periudhës raportuese së cilës i përkasin.

Më shumë informacion në lidhje me pasqyrat financiare, detyrimet tatimore gjendet në faqen zyrtare të [Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve](#).

## 4. Mbrojtja e të dhënave personale

### 4.1. Si rregullohet mbrojtja e të dhënave personale?

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është akti kryesor aktualisht në fuqi në Shqipëri, që rregullon mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale duke përcaktuar detyrimet e kontrolluesve, parimet e përpunimit të ligjshëm, si edhe të drejtat e subjektit të të dhënave.

Ky ligj parashikon se *kontrollues* është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër, që vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.

*Përpunues* është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që përpunon të dhëna personale në emër të kontrolluesit.

Disa nga përkufizimet kryesore të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale mund t'i gjeni në faqen zyrtare të [Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale \(KDIMP\)](#) duke vizituar këtë [link](#).

#### 4.2. Çfarë është një e dhënë personale?

*E dhënë personale* (sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale) është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.

#### 4.3. Cilat aktivitete do të konsiderohen si përpunim i të dhënave personale?

*Përpunim i të dhënave personale* (sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale) është çdo veprim ose grup veprimesh, të cilat janë kryer mbi të dhënat personale, me mjete automatike ose jo, të tilla si mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, shfrytëzimi, transmetimi, shpërndarja ose ndryshe duke vënë në dispozicion, shtrirja ose kombinimi, fotografimi, pasqyrimi, hedhja, plotësimi, seleksionimi, bllokimi, asgjësimi ose shkatërrimi, edhe në qoftë se nuk janë të regjistruara në një bankë të dhënash.

**Përpunimi i të dhënave personale fillon që në momentin e themelimit dhe regjistrimit të shoqërisë/ startup-it në regjistrin tregtar. Mbarëvajtja e aktivitetit të një biznesi përfshin edhe nevojën e përpunimit të të dhënave personale me qëllim përmbushjen e detyrimeve që përcaktohen në ligjin e zbatueshëm, përmbushjen e detyrimeve të ndryshme kontraktuale, apo për qëllime të tjera legjitime të kontrolluesit të të dhënave.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, KDIMDP është autoriteti përgjegjës, i pavarur, që mbikëqyr dhe monitoron, në përputhje me ligjin, mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e informimit, duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

#### 4.4. Përse është e rëndësishme njohja e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale?

*Aksesi në të dhëna personale:* Çdo punëdhënës ka akses në disa të dhëna personale të punëmarrësve të tij, ofruesve të shërbimeve, etj.

*Zbatimi i dispozitave ligjore (compliance):* Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale parashikon rregullat të qarta dhe penalitete në lidhje me mënyrën e trajtimit të të dhënave personale nga çdo kontrollues si edhe detyrimin e njoftimeve pranë autoriteteve përkatëse.

*Integriteti dhe transparenca në përpunimin e të dhënave personale:* Përpunimi me integritet dhe në përputhje me parimin e përgjegjshmërisë dhe transparencës lidhet në mënyrë thelbësore me përmbushjen e kërkesave ligjore, por gjithashtu shmang mungesën e besimit nga ana e konsumatorëve dhe individëve ndaj bizneseve që operojnë në epokën digjitale.

*Siguria e informacionit:* Njohja e legjislacionit të të zbatueshëm garanton marrjen dhe ruajtjen e informacioneve të nevojshme duke shmangur mbajtjen e të dhënave të panevojshme për funksionimin e startup, marrjen e masave për ruajtjen e të dhënave si edhe vendosjen e masave për rikuperimin e të dhënave në rast të përhapjes së tyre.

*Shmangja e gjobave dhe konflikteve gjyqësore:* Shkelja e detyrimeve ligjore parashikuar nga Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale mund të jetë subjekt gjobash që variojnë nga 20 000 (njëzetë mijë) lekë deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë. Mos marrja e masave të nevojshme për mbrojtjen e të dhënave personale mund të bëhet objekt konfliktesh gjyqësore midis kontrolluesit/përpunuesit dhe subjektit të të dhënave.

#### 4.5. A i njihni detyrimet tuaja kryesore si kontrollues të dhënash??

*Detyrimi për informim* - Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni, në përputhje me parashikimet e LMDP. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij.

*Detyrimi për korrigjim ose fshirje* - Kontrolluesi kryen vetë ose me kërkesë të subjektit të të dhënave bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale, kur vëren se janë të parregullta, të pavërteta, të paplota ose janë përpunuar në kundërshtim me ligjin.

*Përgjegjësia për të njoftuar KDIMDP* - Çdo kontrollues duhet të njoftojë KDIMDP për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit të njoftuar më parë. Më shumë informacion për mënyrën e plotësimit dhe depozitimit të formularit të njoftimit mund të gjeni duke vizituar këtë [link](#).

*Hartimi i politikave të privatësisë:* Politika e privatësisë është një dokument i rëndësishëm që përmban tërësinë e rregullave, procedurave, dhe përshkrimin e masave teknike e organizative të marra nga kontrolluesi i të dhënave me qëllim përmbushjen e detyrimeve kryesore të tij në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

Legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale e parashikon shprehimisht si detyrim hartimin dhe miratimin e politikës së privatësisë për kontrolluesit e mëdhenj, megjithatë, hartimi dhe miratimi i një politike privatësie për të gjithë kontrolluesit është një hap i rëndësishëm për të provuar përputhshmërinë e veprimtarisë së tyre me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Një model tip për t'u bazuar gjatë hartimit të politikës së privatësisë mund ta gjeni në faqen zyrtare të KDIMDP, duke vizituar këtë [link](#).

#### 4.6. Çfarë masash teknike dhe organizative mund të marr si startup me qëllim ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale që përpunoj?

*Udhëzimi i KDIMDP Nr. 47 datë 14.09.2018, "Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha",* përcakton rregullat kryesore të subjekteve përpunuese të mëdha lidhur me masat e nevojshme të sigurisë teknike, organizative edhe në lidhje me personelin, për mbrojtjen e të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha.

Bazuar në këtë udhëzim, subjekte përpunuese të mëdha do të konsiderohen kontrolluesit ose përpunuesit të cilët përpunojnë të dhëna personale në mënyrë elektronike ose manuale, duke shfrytëzuar 6 e më shumë persona për të kryer përpunimin, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me anë të përpunuesve.

### III. Kreu III: Si të mbron logon tuaj?

#### 1. Pronësia Intelektuale

Pronësia intelektuale përbën një formë të pronësisë që krijohet si pasojë e krijimeve që ndodhin në mendjen e njeriut. Pronësia Intelektuale ndahet në dy grupe: e drejta e autorit dhe të drejta të lidhura me to dhe të drejtat e pronësisë industriale e cila përfshin patentat, markat tregtare, disenjot industriale, si dhe një formë sui generis siç janë treguesit dhe emërtimet gjeografike.

Të drejtat në lidhje me patentat, markat tregtare, disenjot industriale, treguesit dhe emërtimet gjeografike rregullohen nga Ligji 947, datë 7.7.2008 "Për Pronësinë Industriale" i ndryshuar (këtu e në vijim "Ligji për PI").

## 2. Marka tregtare

Marka tregtare është forma më e njohur dhe e përdorur e pronësisë industriale. Respektimi dhe mbrojtja e markave tregtare nuk është vetëm një domosdoshmëri ligjore, por edhe një angazhim për të mbështetur vlerat e origjinalitetit, drejtësisë dhe besimit në treg. Markat tregtare mbrojnë shenjat e përdorura gjatë aktivitetit tregtar që bëjnë të mundur dallimin e një tregtari nga një tjetër.

Marka duhet të kenë karakter dallues, por jo përshkruar - [për shembull marka tregtare "Mollë" mund të regjistrohet për telefonat por nuk mund të regjistrohet për mollët, pasi do të përshkruante mallin që tregtohet.]

### 2.1. Përse është i rëndësishëm regjistrimi i markës?

- Ekskluziviteti:** Regjistrimi i markës jep mbajtësit të drejtat ekskluzive për përdorimin e asaj marke në lidhje me mallrat ose shërbimet e caktuara.
- Mbrojtje Ligjore:** Regjistrimi i markës ofron mbrojtje ligjore kundër shkeljes. Mbajtësi i markës tregtare ka të drejtë të ndalojë personat e tretë të përdorin pa autorizimin e tij një shenjë që është e njëjtë/ngjashme për mallra/ shërbime të njëjta/të ngjashme, të importojnë/eksportojnë mallra me këtë shenjë, të vendosin markën në mallrat e tyre, të ofrojnë shërbime duke përdorur këtë shenjë, si dhe të kundërshtojë regjistrimin e një marke të njëjta/ngjashme.
- Vlerë pasurore:** Një markë e regjistruar është një pasuri e vlerësueshme në para. Markat tregtare janë pronë e personit në emër të të cilit janë regjistruar. Markat mund t'u transferohen tërësisht ose pjesërisht personave të tretë, të licencohen, të lihen peng dhe të bëhen objekt i veprimeve përmbarimore.

Mos harroni se një ide e pambrojtur është thjesht ajër!

Një ide që mbrohet nga pronësia industriale është një aset!

- Besimi i Konsumatorit:** Konsumatorët shpesh e lidhin markën e regjistruar me cilësinë dhe besueshmërinë. Marka e regjistruar ofron një nivel sigurie dhe mbrojtje nga produktet e falsifikuara.
- Vlefshmëria:** Regjistrimi i markës tregtare detyron mbajtësin e saj të përdorë markën tregtare me qëllim ruajtjen e vlefshmërisë së saj. Mospërdorimi i markës tregtare për një periudhë të pandërprerë prej 5 vitesh do të sillte zhvlerësimin e markës dhe humbjen e të drejtave.

### 2.2. Si mund ta regjistroj markën tregtare?

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI), është autoriteti përkatës në Shqipëri, për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale, ndër to edhe markat tregtare.

Aplikimi në DPPI, kryhet online nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, dhe për këtë është e nevojshme që aplikanti të jetë i pajisur me nënshkrim elektronik. Aplikimi në rastin e subjekteve shqiptare apo

atyre që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri, mund të kryhet nga vetë subjekti, çdo person i autorizuar nga ai, si dhe nga përfaqësuesit e autorizuar të objekteve të pronësisë industriale të cilët janë të licencuar nga DPPI-ja.

Markat tregtare mund të regjistrohen për disa mallra dhe/ose shërbime bazuar në Klasifikimin Ndërkombëtar të Nicës. Për këtë arsye është e nevojshme identifikimi i saktë i mallrave/shërbimeve në klasën përkatëse të Klasifikimit Ndërkombëtar të Nicës.

Me depozitimin e aplikimit, DPPI do të shqyrtojë nëse marka tregtare përmbush kushtet e nevojshme për regjistrimin e saj dhe nëse po do ta publikojë atë në Buletinin Zyrtar. Nëse brenda 3 muajve nga publikimi, asnjë palë e tretë nuk ka kundërshtuar regjistrimin e markës, DPPI do të njoftojë aplikantin për pagesën e tarifës së regjistrimit të markës tregtare me qëllim lëshimin e Certifikatës së Pronësisë.

Të drejtat e fituara nga regjistrimi i markës tregtare pranë DPPI, janë të kufizuara vetëm në Shqipëri, dhe në rast se aktiviteti tregtar shtrihet edhe jashtë territorit shqiptar do të ishte e këshillueshme regjistrimi i markave tregtare edhe për këto territore, me anë të një aplikimi ndërkombëtar në Zyrën Botërore të Pronësisë Intelektuale, ku DPPI vepron si zyra pritëse dhe transferon aplikimin pranë kësaj zyre ndërkombëtare.

Për më shumë informacion vizitoni faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale si edhe lidhjet vijuese:

→ <https://dppi.gov.al/objektetpi/markat/>

→ [https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service\\_code=13401](https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13401)

## IV. Kreu IV: Integriteti dhe etika gjatë ushtrimit të aktivitetit tregtar

### 1. Integriteti dhe etika në biznes

Në botën dinamike dhe konkurruese të startup-eve, respektimi i parimeve bazë të etikës dhe integritetit në mbarëvajtjen e biznesit përbën një shtyllë të rëndësishme me qëllim ushtrimit e veprimtarisë tregtare në mënyrë të qëndrueshme.

Startup-et janë një faktor kyç për vendosjen e standardeve të reja për sjelljen etike dhe me integritet gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare, duke krijuar një kulturë besimi, transparence dhe përgjegjësie që në hapat e para të të bërit biznes.

Suksesi i një startup-i zakonisht varet nga faktorë që shkojnë përtej maksimizimit të fitimit për ortakët apo rezultateve të kënaqshme financiare; një nga faktorët kryesorë për arritjen e suksesit është edhe integriteti dhe baza etike mbi të cilën është ndërtuar e gjithë veprimtaria operationale e shoqërisë/startup-it, si dhe marrja në konsideratë e ndikimit në komunitet dhe respektimit të të drejtave të konsumatorit.

Pavarësisht se legjisllacioni shqiptar nuk vendos një kuadër ligjor ezaurues dhe të përmbledhur në lidhje me ushtrimit e aktivitetit tregtar me integritet, në varësi të llojit të aktivitetit tregtar, ligjvënësi shqiptar vendos rregulla, detyrime dhe kushte që duhet të plotësohen rast pas rasti.

#### Shembull:

Sjellim në vëmendje rastin e ushtrimit të aktivitetit tregtar në fushën e shitjes së produkteve konsumatore. Në varësi të llojit të produktit të tregtuar (p.sh. ushqime apo pajisje elektronike) legjisllacioni për ushqimin apo legjisllacioni për mbrojtjen e konsumatorit vendosin detyrimet përkatëse të shitësit (i.e. startup-et) si edhe përgjegjësinë ndaj blerësit.



Thënë sa më sipër në vijim kemi përfshirë disa aspekte të cilat ndihmojnë çdo startup për të ushtruar aktivitet tregtar me integritet, pavarësisht se jo ezauruese.

### 1.1. Si të veprojmë që të sigurohem se startup-i po operon me integritet?

*Transparenca në komunikim dhe sjellje:* Komunikimi korrekt me klientët, punëmarrësit dhe palët e tjera të interesuara. Promovimi i transparencës dhe sjelljes etike ndihmon jo vetëm në mbarëvajtjen e marrëdhënieve me palët e treta qofshin këta bashkëpunëtorë, klientë, apo punëmarrës por edhe shmangien e konflikteve gjyqësore.

*Praktikat e drejta:* Promovimi i praktikave të biznesit të drejta dhe transparente. Shmangia e diskriminimit, favorizimit ose çdo trajtim të padrejtë të punëmarrësve, klientëve ose partnerëve. Hartimi dhe pasurimi i një Kodi Sjelljeje/ Kodi të Etikës ndihmon në promovimin e transparencës por edhe vendosjen e rregullave të qarta në lidhje me sjelljet jo-etike, shmangien e praktikave korruptive brenda organizatës, vendosjen e rregullave të qarta në lidhje me marrjen dhe pranimin e dhuratave, promovimin e llogaridhënies në rast shkeljeje të Kodit të Sjelljes Etike etj.

*Zbatimi i legjislacionit në fuqi:* Zbatimi i legjislacionit në fuqi dhe ligjeve përkatëse të aplikueshme në varësi të objektit të aktivitetit ndihmon jo vetëm në shmangien e gjobave por edhe konflikteve gjyqësore, dëmit reputacional dhe moral etj. Veprimtaria brenda kufijve ligjorë është një aspekt themelor i sjelljes etike të biznesit.

*Cilësia dhe Përgjegjësia:* Ofrimi i produkteve ose shërbimeve me cilësi të lartë si edhe në përputhje me kushtet e parashikuara në legjislacionin në fuqi. Merrni përgjegjësinë për veprimet tuaja dhe nëse ndodhin gabime, trajtojni ato në mënyrë transparente dhe korrighoni situatën.

*Mbrojtja e konfidencialitetit:* Respektoni dhe mbronni konfidencialitetin e të dhënave personale, pavarësisht nëse ka të bëjë me klientët, punëmarrësit ose operacionet e startup. Ruajtja e konfidencialitetit është një shenjë integriteti.

*Përgjegjësia sociale dhe mjedisore:* Merrni parasysh ndikimin social dhe mjedisor të aktivitetit tuaj. Adoptoni praktika të qëndrueshme dhe kontribuoni pozitivisht për komunitetin duke marrë lejet e nevojshme mjedisore etj.

*Promovimi i Diversitetit dhe Përfshirjes:* Nxitni një vend pune të larmishëm dhe gjithëpërfshirës. Përqa-foni shumëllojshmërinë e mendimeve, prejardhjeve dhe përvojave. Ky angazhim kontribuon në një kulturë drejtësie dhe integriteti. Legjislacioni për mbrojtjen nga diskriminimi dhe [Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi](#) ofrojnë informacionet e nevojshme.

*Shmangia e Konflikteve të Interesit:* Identifikoni dhe menaxhoni konfliktet e mundshme të interesit brenda strukturës suaj. Sigurohuni që interesat personale të mos rrezikojnë integritetin e vendimeve të biznesit.

*Mbrojtja e sinjalizuesve:* Krijoni mekanizma që punëmarrësit të raportojnë sjelljet jo-etike pa frikën e hakmarrjes. Inkurajimi i një kulture ku shqetësimet adresohen menjëherë, mbështet integritetin.

Pavarësisht sa më sipër, në rrjedhën e përditshme të ushtrimit të aktivitetit tregtar duhet të merret parasysh se integriteti nuk është vetëm një grup rregullash, por një mentalitet që përshkon çdo aspekt të aktivitetit tregtar që kontribuon në një kulturë integriteti dhe suksesi afatgjatë.

### 1.2. Më shumë informacion rreth etikës dhe integritetit në biznes

Krahas rregullave dhe detyrimeve që vendos legjislacioni i zbatueshëm në Shqipëri lidhur me shmangien e praktikave korruptive dhe jo etike gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare, si edhe veprat penale të parashikuara në legjislacionin penal, disa burime të rëndësishme që mund të shfletohen me qëllim krijimin e një panorame të qartë të parimeve kryesore të integritetit në biznes janë si vijon:

- [Kodi i sjelljes kundër korrupsionit për komunitetin e biznesit](#), Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2017
- [Rregullat e ICC \(Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë\) për luftën kundër korrupsionit](#), 2011
- [Klauzola e ICC \(Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë\) kundër korrupsionit](#), 2012
- [Udhëzues për ndërgjegjësimin dhe parandalimin e korrupsionit në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme \(SME\)](#), OECD, 2022
- [Strategjia ndërsektoriale kundër korrupsionit 2015-2023](#).

### 1.3. Çfarë është konflikti i interesit?

Përfaqësuesit e shoqërisë (ortaket, administratoret, etj.) kanë detyrimin të përfaqësojnë me besnikëri interesat e shoqërisë, pasi veprimet e kryera prej tyre janë të detyrueshme për shoqërinë edhe nëse këto tejkalojnë objektin e saj. Në vijim kemi paraqitur shkurtimisht disa raste të konfliktit të interesit.

Për të shmangur pagimin e shumave të konsiderueshme monetare ndaj palëve të treta apo qoftë dhe ndëshkimin penal, është e rëndësishme që të gjitha kompetencat e përfaqësuesve të shoqërisë të jenë të shkruara në mënyrë të qartë dhe të mos lënë shumë vend për interpretime. Përveç monitorimit me karakter parandalues, është gjithashtu e nevojshme që punëmarrësit të trajnohen për të identifikuar dhe raportuar rastet e konfliktit të interesit.

Personat në vijim prezumohen të kenë një apo më shumë interesa me personat e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë:

- a) bashkëshorti/bashkëshortja, prindërit, vëllezërit ose motrat e bashkëshortit/ bashkëshortes;
- b) fëmijët, prindërit, vëllezërit, motrat, fëmijët e fëmijëve ose bashkëshorti/bashkëshortja e personave të mësipërm;
- c) personat e lidhur me personin e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë. Persona të lidhur janë: të paralindurit apo të paslindurit, të afërmit në vijë të tërthortë të shkallës së dytë, birësuesi ose i birësuar, i afërmi i shkallës së parë i bashkëshortit/bashkëshortes;
- d) një person, që banon me personin e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë.

### 1.4. Çfarë ndalimesh ka për lidhjen e kontratave me shoqërinë?

Personi i autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë tregtare nuk mund të lidhë kontrata apo të hyjë në marrëdhënie të tjera me shoqërinë tregtare, nëse kjo nuk deklaron kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektit e interesit të tij, e veprimi nuk autorizohet paraprakisht prej personave përkatës (p.sh ortakëve në një Sh.p.k). Çdo miratim paraprak dhe i përgjithshëm njoftohet për regjistrim në QKB.

#### Ortakët/Aksionarët e vetëm

Një person, i cili është, njëkohësisht, administrator dhe ortak apo aksionar i vetëm i shoqërisë, nuk mund të lidhë kontrata huaje apo garancie me shoqërinë. Kontratat e tjera të lidhura midis këtij personi dhe shoqërisë regjistrohen në një procesverbal, i cili bëhet në zyrën qendrore të shoqërisë.

## Palët e lidhura

Miratimi i jepet, gjithashtu, për çdo kontratë apo marrëdhënie tjetër, që shoqëria lidh me një palë të tretë, e cila ka marrëdhënie personale apo financiare me personat e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë (p.sh. administratorë), apo me palë të treta, marrëdhëniet e të cilave me personat e mësipërm janë të tilla që, në mënyrë të arsyeshme, mund të ndikojnë vendimmarrjen e tyre në kundërshtim me interesat e shoqërisë (P.sh. bashkëshortët, bashkëjetuesit, familjarë etj; personat e lidhur me personin e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë).

Sa më sipër është një parashikim i përgjithshëm i cili synon të mbrojë shoqërinë nga lidhja e çdo kontrate me një palë të tretë e cila ndikon apo në mënyrë të arsyeshme mund të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesve të shoqërisë për të lidhur kontrata pa pasur si qëllim primar interesin e shoqërisë.

Shembull: AB është administrator në shoqërinë XY. Bashkëshortja e AB, zonja CD është ortak e vetme e shoqërisë YZ e cila do të ofrojë shërbime konsulence ndaj shoqërisë XY. Djali i AB është administrator i shoqërisë YZ.

Në rastin në fjalë ka arsye të dyshohet në paanshmërinë e administratorit AB për të lidhur një kontratë me shoqërinë YZ për shkak të interesave personale dhe financiare.

Sa më sipër, zgjedhja e kësaj shoqërie për ofrimin e shërbimeve të konsulencës mund të mos jetë në interesin më të mirë të shoqërisë XY.

## Dhuratat

Politikat e shoqërisë për dhuratat duhet të jenë të mirë përcaktuara. Këtu përfshihet forma e dhuratave të pranueshme, limiti i vlerës maksimale të dhuratave, detyrimi për të marrë aprovimin nga, ose për të njoftuar, departamentin/personin përkatës brenda shoqërisë për dhuratat, etj.

Pranimi i dhuratave mbi një limit të caktuar sipas përcaktimeve të shoqërisë, përveç cënimit të reputacionit të individit që i pranon dhe të reputacionit të shoqërisë si e tërë, mund të përbëjë edhe vepër penale në përputhje me parashikimet e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë<sup>4</sup>.

### 1.5. A i zbatohen një startup-i dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit?

Sipas Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, subjektet që përfshihen në fushën e zbatimit të këtij ligji janë kryesisht subjektet që operojnë në sektorin financiar, si bankat, institucionet financiare jo-bankare, bursat, shërbimet postare që kryejnë shërbime pagesash, shoqëritë e sigurimeve, lojërat e fatit, si dhe profesionet e lira, agjentët e pasurive të paluajitshme, cdo person fizik ose juridik, i cili merret me ofrimin e shërbimeve të mjeteve virtuale, çdo individ, person fizik apo juridik, që tregton mallra apo shërbime në masën që kryen apo pranon pagesa në para fizike në një shumë prej 1 000 000 (një milion) lekësh ose më shumë, pavarësisht nëse transaksioni kryhet në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione të lidhura, audituesit, kontabilistët e miratuar etj.

Personat si më sipër kanë detyrimin e identifikimit të klientit dhe raportimit të transaksioneve të dyshimta, në përputhje me kushtet dhe kriteret që vendos ligji në fjalë.

<sup>4</sup> Neni 164/a i Kodit Penal Korrupsioni aktiv në sektorin privat parashikon: "Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, personit që ushtron funksion drejtues në shoqëri tregtare ose punon në çdo pozicion në sektorin privat, për të kryer ose mos kryer një veprim në kundërshtim me detyrën ose funksionin e tij, dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet". Neni 164/b i Kodit Penal Korrupsioni pasiv në sektorin privat parashikon: "Kërkimi a marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt a i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi, që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksion drejtues ose punon në çdo pozicion në sektorin privat, për të kryer ose mos kryer një veprim në kundërshtim me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet".

Njohja e legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave ndihmon në mbarëvajtjen e aktivitetit të startup-it që bie në fushën e zbatimit të ligjit të mësipërm, si edhe shmangien e transaksioneve të dyshimta të cilat mund të bëhen shkak për hetime të mëtejshme apo edhe penalitete.

Njohja e legjislacionit por edhe hartimi i politikave të brendshme ndihmon në shmangien e abuzimeve si edhe informimin e punëmarrësve të startup-it, vlerësimin e rrezikut si edhe marrjen e masave mbrojtëse.

Në mënyrë të përmbledhur, startup-et duhet të jenë të vetëdijshëm për detyrimet ligjore dhe të angazhohen në praktika të biznesit që promovojnë transparencën dhe parandalimin e aktiviteteve të paligjshme.

### 1.6. Çfarë detyrimesh ka një startup në kuadër të legjislacionit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve?

Sipas Ligjit për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve, përcaktohet se për subjektet private me mbi 100 punëmarrës, është e detyrueshme të caktohet një njësi përgjegjëse për regjistrimin, hetimin dhe shqyrtimin e sinjalizimeve.

Ky ligj përcakton rregullat për sinjalizimin e një veprimi ose praktike të dyshuar korrupsioni nga sinjalizuesit në sektorin publik e privat, mekanizmat për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe detyrimet e autoriteteve publike e të subjekteve private në lidhje me sinjalizimin.

Zbatimi i detyrimeve të përcaktuara në Ligjin për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve merr një rëndësi të veçantë për sa i përket denoncimit të shkeljeve dhe praktikave të gabuara, promovimin e përgjegjësisë ndaj praktikave të gabuara, promovimi i vlerave të shoqërisë, zbatimi i dispozitave ligjore si edhe promovimi i një kulture etike.

Çdo person, i cili vihet në dijeni për veprime ose praktika të dyshuara të korrupsionit, gjatë punës ose në lidhje me veprimtarinë e tij të punës pranë startup-it, ka të drejtë të sinjalizojë këtë fakt tek njësi përgjegjëse brenda organizatës ose Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), sipas rastit.

Sinjalizuesit i ofrohet mbrojtja për sinjalizimin e kryer në kushtet e mirëbesimit, të një veprimi ose praktike të dyshuar korrupsioni, sipas kriterëve të parashikuara në ligj.

Sinjalizimi bëhet me çdo mjet komunikimi, në formë të shkruar ose deklarohet verbalisht para ILDKPKI-së ose njësisë përgjegjëse dhe dokumentohet me shkrim prej tyre.

**Çdo subjekt privat, i cili ka më shumë se 100 të punësuar** cakton një njësi përgjegjëse, e cila regjistron, heton dhe shqyrtton sinjalizimet.

ILDKPKI-ja heton drejtpërdrejt sinjalizimin për veprimet ose praktikave të dyshuara të korrupsionit në organizata, të cilat **nuk kanë një njësi përgjegjëse për këtë qëllim.**

## ?

### Përmbledhje: Pyetjet më të shpeshta nga bizneset (FAQs)

#### 1. Kur mund të fillojë shoqëria ushtrimin e aktivitetit tregtar

Shoqëria mund të ushtrojë aktivitet tregtar me regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Personat që veprojnë në emër të shoqërisë, përpara se kjo të fitojë personalitetin juridik, përgjigjen personalisht në mënyrë të pakufizuar e solidare për veprimet e kryera në emër të saj. Me fitimin e personalitetit juridik, të drejtat e detyrimit që rrjedhin nga këto veprime i kalojnë shoqërisë.

#### 2. Cila është forma më e mirë e organizimit të aktivitetit tregtar?

Ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare parashikon disa forma të organizimit tregtar qoftë si person fizik tregtar qoftë si person juridik. Në varësi të llojit të aktivitetit tregtar që synohet të zhvillohet përcaktohet edhe forma më e përshtatshme e organizimit tregtar. Zakonisht, duke marrë parasysh kufizimin e përgjegjësive (përgjegjësia e ortakëve limitohet në vlerën e papaguar të kuotës) por edhe organizimin dinamik, forma më e përhapur e shoqërisë është ajo e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

#### 3. A kam nevojë të licencohem për çdo aktivitet tregtar të zhvilluar?

Nevoja për licencim nuk është në çdo rast. Në varësi të aktivitetit të zhvilluar, mund të lind nevoja për licencim. Për më shumë, mund të shihni [në faqen zyrtare të QKB](#).

#### 4. Çfarë detyrimesh kam ndaj punëmarrësve të mi?

Lidhja e kontratës së punës me shkrim është hapi i parë dhe më i rëndësishëm në lidhje me rregullimin e marrëdhënies së punës. Kontrata e punës sugjerohet të lidhet pa afat (përveç nëse pozicioni i punës legjitimon nevojën për një kontratë me afat) si edhe të përmbajë të gjithë elementët e detyrueshëm siç përcaktohen nga Kodi i Punës. Kodi i Punës përcakton disa detyrime të mëtejshme të punëdhënësit ndaj punëmarrësve duke përfshirë, pushimet e paguara dhe të papaguara, rregullimin e punës në ditët e festave zyrtare, orët shtesë, siguria dhe shëndeti në punë etj.

#### 5. Cili është kapitali i nevojshëm për të ushtruar aktivitet tregtar?

Në varësi të llojit të aktivitetit tregtar të zhvilluar por edhe formës së organizimit të shoqërisë, ligji parashikon edhe limitet në kapitalin e saj. Në rastin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, kapitali minimal duhet të jetë 100 Lekë.

#### 6. Çfarë ndihme mund të përfitoj si startup?

Në kuadrin e mbështetjes për startup-et, nëpërmjet shërbimit "startup one-stop-shop" që ofrohet nga Ministria e Sipërmarrjes gjate periudhës 24 mujore të inkubimit (vënies në jetë dhe aplikimit praktik të idesë së biznesit) aplikohet tarifa 0 për këto shërbime që jepen në bashkëpunim me institucionet publike:

- a) dhënie informacioni dhe këshillim për kuadrin ligjor rregullator në fuqi për startup-et dhe personat fizikë e juridikë; mbështetja e iniciativave që kanë ndikim pozitiv mjedisor;
- b) dhënie informacioni dhe këshillim për detyrimet lidhur me marrëdhëniet e punës, sigurinë dhe shëndetin në punë;
- c) dhënie informacioni dhe këshillim për detyrimin për regjistrimin në regjistrin tregtar, në përputhje me legjislacionin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare; fuqizimi i përfshirjes sociale, diversiteti dhe impakti social;
- d) dhënie informacioni dhe këshillim për detyrimet fiskale dhe detyrime të tjera që rrjedhin nga regjistrimi në regjistrin tregtar dhe atë të vetëdeklarimit si startup; Gjithashtu në kuadrin e mbështetjes për startup-et, nëpërmjet shërbimit "startup one-stop-shop" që ofrohet nga Ministria e Sipërmarrjes gjate periudhës 24 mujore të inkubimit (vënies në jetë dhe aplikimit praktik të idesë së biznesit) aplikohet tarifa 0 për këto shërbime që jepen në bashkëpunim me institucionet publike:
- e) vetëdeklarimi në regjistrin e startup-eve, të parashikuar në Ligjin për Startup;
- f) dhënie informacioni dhe këshillim për regjistrimin dhe mbrojtjen e pronësisë intelektuale;
- g) dhënie informacioni dhe këshillim për investimet strategjike bazuar në legjislacionin në fuqi për investimet;
- h) dhënie informacioni, këshillim dhe mundësi rrjetëzimi me investitorë të huaj, strategjikë, engjëj biznesi, fonde të mbledhura;
- i) dhënie informacioni, këshillim dhe gjetje partneritetesh, duke mundësuar kontaktet dhe lidhjen me rrjete ndërkombëtare për ndërmarrjet, startup-et dhe investitorët;
- j) mbështetje, informacion dhe këshillim për grantet, fondet dhe masat e tjera mbështetëse të vëna në dispozicion nga qeveria;
- k) mbështetje, informacion dhe këshillim për grantet ose fondet e donatorëve të tjerë të huaj dhe vendas në Shqipëri.

Startup-et mund të përfitojnë mbështetje financiare me fonde buxhetore në formën e granteve, si dhe nga burime të tjera financimi, përfshirë, donacionet e huaja, investimet e lehtësuesve, etj., nëse plotësojnë kriteret dhe rezultojnë fitues pas një procesi konkurrues e transparent përzgjedhjeje.

Për dhënien e granteve, Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e StartUp-eve dhe Lehtësuesve (këtu e në vazhdim, e njohur si StartUp Albania) vlerëson aplikimet si me poshtë:

Mbështeten me grant **startup-et** që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) kanë përfunduar vetëdeklarimin në regjistrin elektronik të startup-eve dhe janë pajisur me pasaportën e startup-it përpara aplikimit;
- b) Startup-et që përzgjedhin fazën aktuale të zhvillimit të specifikuar nëpërmjet formave të aplikimit: i. faza fillestare (F1); ii. faza e validimit (F2); iii. faza e rritjes (F3);
- c) Startup-et në fazën fillestare, e hershme, (F1) mund të jenë individë privatë, vendas ose të huaj, përfshirë nomadin digjital, të cilët kanë plan të vijojnë operacionet e biznesit në Shqipëri;
- d) Startup-et në fazën e validimit (F2) dhe fazën e rritjes (F3) duhet të jenë biznes i regjistruar ligjrisht në regjistrin tregtar të Republikës së Shqipërisë dhe jo më të vjetër se 6 (gjashtë) vjet në kohën e kërkesës;
- e) Të kenë përmbushur shlyerjen e detyrimeve tatimore në momentin e kërkesës;
- f) Një kërkues nuk mund të aplikojë më shumë se një herë për të njëjtën thirrje.

StartUp Albania harton dhe publikon në faqen e internetit:

- a) thirrjen publike për kërkesa për përfitimin e granteve e të masave mbështetëse nga startupet dhe lehtësuesit e startup-eve;
- b) fondin në dispozicion për çdo thirrje;
- c) dokumentacionin për përgatitjen dhe dorëzimin e kërkesave;
- d) formularët e kërkesës;
- e) kontratën tip;
- f) udhëzimet e detajuara, të cilat përmbajnë informacion për:
  - i. mënyrën e shpërndarjes së fondeve dhe zbatimin e projektit;
  - ii. procedurën e zbatuar;
  - iii. kriteret minimale të kualifikimit dhe dokumentacionin, që provon plotësimin e tyre;
  - iv. kushtet e grantit;
  - v. afatet kohore dhe formalitetet, që duhet të respektohen;
  - vi. kriteret e përdorura për përzgjedhjen e kandidatëve;
  - vii. ndarjen e zërave në terma financiarë;
  - viii. mënyrën e vlerësimit të kërkesave;
  - ix. detyrimet e raportimit për zbatimin e grantit; x. mënyrën e kryerjes së monitorimit të projekteve;
- g) ndryshimet e kryera dhe sqarimet e bëra përgjatë procedurës;
- h) listën e projekt propozimeve dhe të kandidatëve pjesëmarrës për përfitimin e granteve;
- i) vlerësimet përfundimtare të projekt propozimeve, kryer nga komisioni i vlerësimit dhe miratuar nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen.

Në shpalljen e thirrjes evidentohen edhe forma dhe sasia e granteve financiare që parashikohen të akordohen. Kërkesa për mbështetje me grant kryhet elektronikisht nëpërmjet portalit "e-Albania". Afati për dërgimin e kërkesave për masa mbështetëse dhe periudha e thirrjes nuk mund të jetë më pak se 10 (dhjetë) ditë kalendarike dhe jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë. Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të shoqërojë kërkesën për masa mbështetëse përcaktohet në rregulloren e shpallur të thirrjes.

Startup-eve dhe lehtësuesve iu lëvrohet fondi për projektin në 3 (tri) këste:

- a) *Kësti i parë*: 30% (tridhjetë për qind) të vlerës së fondit menjëherë pas nënshkrimit të kontratës së grantit;
- b) *Kësti i dytë*: 40% (dyzet për qind) të vlerës së fondit menjëherë pas miratimit nga StartUp Albania të raportit përshkrues dhe financiar të fazës së parë; dokumentacionin për përgatitjen dhe dorëzimin e kërkesave;
- c) *Kësti i tretë*: 30% (tridhjetë për qind) të vlerës së fondit pas miratimit nga StartUp Albania të raportit përshkrues dhe financiar përfundimtar

Në kontratën e grantit përcaktohen rregullat, afatet e përgjegjësitë e palëve për realizimin e projektit, dokumentacioni dhe afatet për raportimin përshkrues e financiar, mënyra e transferimit të fondeve, shpenzimet e njohura e të pranueshme, mekanizmat e raportimit e të kontrollit, përfshirë detyrimin e subjektit përfitues për të vënë në dispozicion të Kontrollit të Lartë të Shtetit dokumentacionin për veprimtarinë financiare të kryer, mënyra e dokumentimit të shpenzimeve të kryera dhe të produkteve e aktiviteteve të realizuara.

StartUp Albania kryen lëvrimin e fondit sipas parashikimeve të kontratës së nënshkruar me fituesit e granteve.

### 7. Si mund të financoj ushtrimin e aktivitetit tregtar?

Ka disa forma të financimit të aktivitetit tregtar si vijon:

- ✓ Fonde personale;
- ✓ Hua;
- ✓ Kredi bankare;
- ✓ Financime nga sipërmarrës;
- ✓ Engjëj biznesi
- ✓ Financime nga fondet publike kombëtare;
- ✓ Financime nga fonde të huaja (i.e. IPARD etj).
- ✓ Te tjera

### 8. Çfarë duhet të kem parasysh për të ushtruar aktivitet tregtar me integritet?

Është e rëndësishme të kuptohet se integriteti nuk është një detyrim i vetëm për t'u përmbushur nga një startup por një mori detyrimesh dhe sjelljesh të cilat duhet të jenë në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm, praktikat e mira të biznesit por edhe sjelljes etike.

Në këtë udhëzim kemi dhënë disa shembuj të ushtrimit të aktivitetit tregtar me integritet.

### 9. Si mund të mbrohem ndaj "vjedhjes" së idesë së biznesit?

Ju mund të mbroheni fare lehtë ndaj vjedhjes duke regjistruar markën, patentën, dizenjon përkatëse duke përfituar kështu edhe nga mbrojtja ligjore që ofron ky regjistrim.

Në rast se ideja juaj nuk përfshin një inovacion të regjistrueshëm në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e së drejtës së autorit dhe pronësinë industriale, ju mund të hartoni dhe lidhni kontrata për ruajtjen e konfidencialitetit (*Non Disclosure Agreement*) me cilindo person të cilit do t'i komunikoni këtë informacion.



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
Prezenca në Shqipëri

**Deloitte.**  
Legal

